



## UBT WILL GROW

Interview with vicepresident of UBT, Derek Shields...[F28-29](#)



## NË UBT U ZHVILLUA CEREMONIA E DIPLOMIMIT 2010

Në këtë ceremoni studimet bachelor i përmbyllën 280 studentë të katër Fakulteteve...[F06-07](#)

## KOSOVA DREJTË OKB-SË

UBT organizoi konferencën "Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe hulumtimet për paqe" ...[F010](#)

## STUDENTI I UBT-SË KOMPOZON "HITIN" E VERËS "LEJ FLESHAT"

Arijan Haxhixhemajli vetëm 20 vjeçar, me kompozimet ...[F23](#)



## FILLON BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN E RIJEKËS

UBT-ja fillon bashkëpunimin me Kroacinë...[F015](#)

## TVSH, TATIM STIMULUES APO DESTIMULUES PËR INVESTIMET NË KOSOVË

Në përgjithësi tatimet shihen si burim kryesor i të hyrave të qeverisë. Qeveria ka për obligim të aplikojë ...[F031](#)

## MISH, PEMË DHE PERIME ME BOLLËK

Në UBT u prezantuan dy hulumtime si Shitësitë ambulante dhe Tregtia ndërkombëtare e mishit në Kosovë...[F022](#)

# UBT-ja e nderoi Kryeministrin Thaçi me "Leadership Excellence Award"

Kryeministri Thaçi për kontributin e jashtëzakonshëm dhe performansën e tij si lider për çlirimin dhe zhvillimin e vendit prof. dr. Edmond Hajrizi dhe Këshilli Akademik i UBT-së, si shenjë respekti e nderuan me Çmimin më të lartë që parashihet Stauti i UBT-së, "Leadership Excellence Award"



# UBT FILLON BASHKËPUNIMIN ME UNIVERSITETIN CITY

"UBT ka qenë gjithër aktive në ofrimin e mundësive dhe bartjeve të dijeve nga universitetet të njohura botërore me anë të marrëveshjeve dhe të bashkëpunimeve. Dhe një marrëveshje të tillë e kemi filluar edhe me Universitetit City, i cili do të mundësojë studenteve kosovarë që studimet universitare ...



**Editorial**

# Urime viti i ri akademik ...

**EDMOND HAJRIZI**  
President i UBT-së

Të nderuar profesorë dhe studentë të Universitetit për Biznes dhe Teknologji UBT, më lejoni që në emër të UBT-se të iu uroj fillimin e vitit të ri akademik 2010/2011, i cili vjen si i teti me radhë, prej se UBT ka filluar punën.

Ju dëshirojmë shumë sukses.

Ne jemi shumë të nderuar që ju jeni pjesë e jona dhe që bashkërisht do të punojmë në arritjen e rezultateve dhe sukseseve akademike dhe profesionale.

Në këtë rast dua të falënderoj posaçërisht udhëheqjen e UBT-së, departamentet, personelin, studentët ambasador, dhe individë të tjerë të involvuar me orë të tëra për të bërë këtë fillim të suksesshëm.

**RRITET NUMRI I STUDENTEVE TË RINJ NË UBT ...**

UBT në këtë vit ka shënuar numër edhe më të madh të të regjistruarve për studime në krahasim me vitet e kaluara. Po ashtu, edhe sivjet ka një numër shumë të madh të studentëve të cilët kanë kaluar (transferuar) nga universitetet e tjera në UBT. Numri më i madh i transfereve vjen nga Universiteti i Prishtinës, por ka edhe shumë të tjerë që vijnë nga universitetet dhe institucionet e tjera të Kosovës si dhe nga universitetet jashtë vendit.

Besoj se kjo tregon shumë qartë se kush po ofron cilësi në edukimin e lartë në Kosovë, duke marrë parasysh edhe faktin se Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Prizrenit ka vendosur të ofrojë shumë më shumë vende të lira për studime në këtë vit. Kjo tregon qartë se studentët nuk dëshirojnë më vetëm një diplomë.

Ata duan që përmes studimeve të përfitojnë dhe të rrisin prestigjin e tyre në shoqëri, të jenë të suksesshëm në profesionin e tyre si dhe të krijojnë dhe përfitojnë një jetë me cilësi dhe vlera.

**SUKSESET E UBT DALIN SI REZULTAT ...**

... i një përkushtimi disavjeçar i studentëve, për të studiuar, dhe për të ndërtuar një dije dhe një personalitet lideri në njërin prej profesioneve të zgjedhura, me qëllim të arritjes së një cilësie më të lartë jetësore për vete dhe për shoqërinë.

... i një planprogrami modern që UBT e ka krijuar me vite, duke u bazuar në standardet evropiane dhe amerikane të studimeve por edhe në bazë të nevojave dhe kërkesave që dalin nga tregu i punës.

... i angazhimit të një stafi akademik, me një eksperiencë të lartë ndërkombëtare si në shkencë ashtu edhe në aspektin profesional. Më shumë se 200 profesorë dhe ekspertë, nga katër kontinente, nga 20 vende dhe kultura të ndryshme, nga rreth 50 universitete dhe institucione partnere me renome botërore, po sjellin në UBT përvojën dhe dijen e tyre në këto programe ku ju, të nderuar studente po studioni. Kjo ka krijuar një ambient unik ndërkombëtar, ndërkulturor dhe interdisiplinar jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë.

**NEVOJA PËR NJË LIDER PROFESIONAL**

... është kërkesë e përditshme kudo në botë, dmth edhe në Kosovë.

Ne po punojmë çdo ditë që të zhvillojë një personalitet, i cili është shumë i përgatitur profesionalisht, është i përkushtuar në punë, ka shkallë të lartë kreativiteti dhe inovacioni, ndërton partneritete me të tjerët, ndihmon veten dhe shoqërinë, puna e tij bazohet në fakte dhe rezultate, ka një aftësi të lartë ndërkulturore dhe interdisiplinare, por ka edhe një komunikim modern të bazuar në vlerat më të larta.

Studimet në UBT kanë pasur dhe kanë pikërisht një qëllim: ofrimin e veglave dhe aftësive të nevojshme individit (studentit tonë), për të marrë vendime racionale dhe që i garantojnë atij suksese dhe vlera që bazohen në vlerat më të larta evropiane dhe ndërkombëtare.

Detyra kryesore është që t'ia ofrojmë studentit tonë të gjitha arritjet e fundit në shkencën e menaxhimit, në ekselencën biznesore, në teknologjinë më moderne, në robotikë, në arkitekturë, në dizajn, planifikim hapësinor, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, në drejtësi në integrimet evropiane por edhe në kompetencën sociale.

Suksesi i arritur i studentëve tanë në punësim, në përfaqësim e Kosovës në Kampionate Evropiane, në konkurrim me planet dhe idetë e tyre inovative në biznes dhe teknologji, pjesëmarrja aktive në forume dhe konferenca ndërkombëtare, janë shembujt dhe dëshmitë më të mira për këtë.

*UBT ... nuk është vetëm DIPLOME ... është PRESTIGJ ... është SUKSES ... është CILËSI*

*UBT jeni JU ... URIME DHE SUKSESE ...*

**— I M P R E S U M —**

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së.

KRYEREDAKTORE: Naile Demiri

REDAKTOR PERGJEGJES DHE REALIZIMI TEKNIK: Herolind Beqaj.

ADRESA: www.ubt-uni.net



**UNIVERSITY EDUCATION  
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY**  
AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY



UBT-ja bashkëpunon Londrën

## UBT fillon bashkëpunimin me Universitetin City

“UBT ka qenë gjithëherë aktive në ofrimin e mundësive dhe bartjeve të dijeve nga universitetet të njohura botërore me anë të marrëveshjeve dhe të bashkëpunimeve. Dhe një marrëveshje të tillë e kemi filluar edhe me Universitetin City, i cili do të mundësojë studenteve kosovarë që studimet universitare në nivelin bachelor, master dhe në doktoraturë të ndjekin në UBT dhe në Universitetin City, po ashtu stafit akademik zhvillim e kompetencës në fushën hulumtuese dhe zhvillimore. Bashkëpunimi do të ofrojë edhe programe të tjera te veçante si janë projektet, seminarët, transferi i teknologjisë, dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet”, theksoi Presidenti i UBT, Edmond Hajrizi, gjatë takimit me palët nënshkruese

**Prishtinë, 28 korrik:**

Në kuadër të vazhdës së Marrëveshjeve të Bashkëpunimit, që Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) i ka me universitete më prestigjioze në botë dhe Evropë, gjatë këtyre ditëve një delegacion nga Universiteti City në Londër (Angli) i prirë nga Prof. Dr. Grattan dhe Prof. Dr. Khan, po qëndron për vizitë dy ditore në Kosovë, gjegjësisht në UBT, sot më 28 korrik 2010, në ambientet e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), për të filluar bashkëpunimit ndëruniversitar në mes të UBT-së dhe Universitetit City në Londër, Angli.

Me këtë rast, presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Edmond Hajrizi, së bashku me delegacionin nga Universiteti City në Londër (Angli) i prirë nga Prof. Dr. Grattan dhe Prof. Dr. Khan, në lokalet e UBT, në Prishtinë ftuan zyrtarisht të gjithë profesorët vendore dhe ndërkombëtare si dhe studentët e dy universiteteve për të qene pjese e programeve te përbashkëta te cilët ata i prezantuan.

“UBT ka qenë gjithëherë aktive në ofrimin e mundësive dhe bartjeve të dijeve nga universitetet të njohura botërore me anë të marrëveshjeve dhe të bashkëpunimeve. Dhe një marrëveshje te tillë e kemi filluar edhe me Universitetin City, i cili do të mundësojë studenteve kosovarë që studimet universitare në nivelin bachelor, master dhe në doktoraturë të ndjekin në UBT dhe në



Universitetin City, po ashtu stafit akademik zhvillim e kompetencës në fushën hulumtuese dhe zhvillimore. Bashkëpunimi do të ofrojë edhe programe të tjera te veçante si janë projektet, seminarët, transferi i teknologjisë, dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet”, theksoi Presidenti i UBT, Edmond Hajrizi, gjatë takimit me palët nënshkruese.

Sipas tij, bashkëpunimi ka filluar në shtator të vitit të kaluar mes dy universiteteve, nga ana tjetër Prof. Dr. Grattan nga Universitetin City, pohoi se marrëveshja është incizuar nga të dy palët.

Delegacioni qëndroi dy ditë në Kosovë pikërisht në UBT dhe u mirëpritet nga Presidenti Edmond Hajrizi dhe zëvendëspresidenti Derek Shields dhe stafi akademik vendore dhe ndërkombëtar dhe

studentët e të gjitha Fakulteteve të UBT-së.

Delegacioni u nda i kënaqur me të arritura e UBT, sidomos me programet e studimit më teknologjinë më moderne, me infrastrukturën, me stafin akademik dhe me arritjet e studenteve.

Presidenti i UBT, E. Hajrizi si shenj respekti mysafirët i nderoi me simbolin më të vjetër autokton të popullit shqiptar me Plisin e bardhë.

Universitetin City numëron një numër të konsiderueshëm të mësimdhënësve dhe ka marrëveshje shumta bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare, është themeluar që 100 vite e më shumë, numri i të diplomuarve është i krahasueshëm me universitete më të mëdha në botë, po ashtu të diplomuarit sot janë në vende udhëheqëse nëpër kompani dhe organizata më profitabile në Evropë dhe botë.

## Studentë të UBT-së fituan bursa studimi nga kompania IPKO Fondation

Anesa Ramaxhiu, Ariani Agani dhe Valbona Fejzullahu, studentë të vitit të parë në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), janë fituesit e bursave të studimeve nga kompania “Ipko foundation”, në vlerë me mbi 80% të pagesës së semestrit për vitin akademik 2010/2011.

“ Falë bursës ne gjithmonë do të kemi takime të ndryshme me bursistët dhe me persona të ndryshëm që kanë arritur suksese në jetën e tyre”, tha Anesa Ramaxhiu për gazetën “UBT News”.

Kriteret për marrjen e bursës në fjalë kanë qenë parakusht që studentët të kenë notën

mesatare mbi 8.5, të shkruajnë tri ese për vizionin e tyre për teknologjinë si në gjuhën angleze, t’i cekin përvojat e tyre të më hershme, ku kanë punuar ose nëse kemi qenë anëtare të ndonjë organizate etj.

Mënyra e vlerësimit për ndarjen e bursave nga na e jurisë ka qenë shumë transparente.

Me rastin e ndarjes së bursave është mbajtur edhe një koktej në restorant “Tiffany” në Prishtinë, ku i pranishëm ishte edhe ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë z.Enver Hoxhaj, me ç’rast përshëndeti kompaninë IPKO foundation dhe bursistët.



rrethi yt



Kryeministri i vendit z. Hashim Thaçi mbajti ligjëratë para studentëve dhe stafit akademik të UBT-së

# UBT-ja e nderoi kryeministrin Thaçi me

Kryeministri Thaçi për kontributin e jashtëzakonshëm dhe performansën e tij si lider për çlirimin dhe zhvillimin e vendit prof. dr. Edmond Hajrizi dhe Këshilli Akademik i UBT-së, si shenjë respekti e nderuan me Çmimin më të lartë që parasheh Stauti i UBT-së, "Leadership Excellence Award"

**Prishtinë, 29 qershor:**

"Proceset në të cilat po kalon Kosova në integrimin e saj në Bashkimin Evropian dhe sfidat të cilat e presin vendin në këtë proces", sot u ligjërua tema e radhës, për të cilën, para studentëve dhe stafit akademik dhe vendore dhe ndërkombëtar të UBT-së, ligjëroi Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi.

Kryeministri shprehi konsideratë të lartë për UBT-në, për studentët të cilët janë e ardhmja e këtij vendi the tha se "Arsimi është prioritet i lartë për Qeverinë time. Si Kryeministër, ka qenë obligimi dhe përkushtimi im ndaj jush që të ndërtojmë sistemin më modern të arsimit në rajonin tonë. Dhe këtë jemi duke arritur", theksoi mes tjerash kryeministri Hashim Thaçi në ligjëratën e tij në UBT.

Është kënaqësi e veçantë për mua të marr pjesë në ligjëratën e sotme, të flasim për progresin e Kosovës, për sfidat që kemi përpara dhe natyrisht t'ju përgjigjem pyetjeve tuaja".

Pas një debati shumë të vëmendshëm nga të pranishmit mes kryeministrit dhe studentëve, presidenti i UBT, Edmond Hajrizi, nderoi kryeministrin e vendit më çmimin më të lartë që ndan UBT-ja.

"Kryeministri Thaçi për kontributin e jashtëzakonshëm dhe performansën e tij si lider për çlirimin dhe zhvillimin e vendit unë presidenti i UBT-së dhe Këshilli Akademik, si shenjë respekti të nderojmë me Çmimin më të lartë që parasheh Stauti i UBT-së, "Leadership Excellence Award", tha presidenti Hajrizi dhe urojë kryeministrin e vendit z. Thaçi për zotërimi për çmimin e dhënë.

I shoqëruar me studentë dhe me stafin akademik, me media, Kryeministri z. Thaçi për së afërmi vizitoje dhe Laboratorin e Mekatronikës, të vetmin laborator në vend dhe rajon.

Kryeministri u nda i kënaqur



për të arritura e teknologjisë më bashkëkohore në lëmin e shkencës që ka sektori i arsimit të lartë në Kosovë, pikërisht UBT-ja.

**Fjalimi i Kryeministrit z. Hashim Thaçi drejtuar stafit**

**akademik dhe studentëve të UBT**

I nderuar staf akademik i Kolegjit UBT,

**TË NDERUAR STUDENTË,**

Sot Kosova njihet nga 69 shtete anembanë botës, dhe është

anëtarë e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe e Bankës Botërore.

Ne po bëjmë përpjekje për të qenë anëtare e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim – ka mbetur të sigurojmë vetëm edhe një votë për anëtarësim.

Sot Kosova është e pavarur, sovranë dhe Kosova është shtet funksional.

Sot populli i Kosovës mund të krenohet me arritjet e tij por, njëkohësisht, ai nuk mund të dorëzohet para sfidave të vështira që i ka.

Në të ardhmen e afërt, Kosova



# "Leadership Excellence Award"



do të jetë përballë opinionit të shumëpritur të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Çfarëdo që të jetë opinioni, pavarësia jonë është e pakthyeshme dhe kufijtë tanë janë të pacenueshëm.

Ne do të vazhdojmë të ecim përpara dhe do ta kemi mbështetjen e miqve dhe partnerëve tanë.

Sfida jonë kryesore është për të ecur përpara me aspiratat tona Euro-Atlantike – drejt anëtarësimin tonë në Bashkimin Europian dhe në NATO.

Objekti im kryesor për vitin 2010 është që të kemi një Raport të Progresit, i cili është pozitiv për Kosovën.

Lidhur me përpjekjet tona për integrim, ne i kemi dorëzuar përgjigjet tona në pyetësorin për marrëdhënie tregtare me BE-në; tash i presim rekomandimet nga ana e BE-së.

Institucionet e Kosovës janë poashtu gati për udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave dhe unë e kam theksuar në të gjitha takimet me përfaqësues të BE-së, përfshirë në vizitën time të fundit në Bruksel – Kosova nuk do të mbetet vrimë e zezë në rajonin e Europës Jug Lindore.

## TË NDERUAR STUDENTË,

Pikërisht ju mund të përfitonit shumë nga liberalizimi i vizave përshkak se kjo do t'ju mundësojë lehtësira të mëdha në shkëmbimet akademike me vende të ndryshme Europiane.

Të nderuar profesorë e studentë të Kolegjit të Biznesit, Krahas angazhimeve tona për integritime Europiane, ne synojmë

ta përmirësojmë rritjen ekonomike.

Në Kosovë, rritja ekonomike gjatë vitit të fundit kap shifrën prej afërsisht 4%.

Për vitin 2010 do të shënojmë rritje prej rreth 6%.

Ndërsa, për periudhën e ardhshme makro-fiskale 2011-2013 planifikojmë rritje të vazhdueshme prej mbi 6%.

Kosova ka nevojë për norma më të larta të rritjes ekonomike për të ulur nivelin e lartë të papunësisë, sidomos tek rinia jonë.

Për të arritur këtë, Qeveria e ka përmirësuar ekzekutimin e shpenzimeve kapitale, duke ndërtuar një infrastrukturë moderne.

Nga 155 milion euro ne vitin 2007, në vitin 2008 kemi realizuar 347 milion euro investime, një ngritje mbi 120%.

Ne vitin 2009 kemi investuar mbi 400 milion euro.

Ndërsa këtë vit planifikojmë të investojmë rreth 500 milion euro. Krahasuar me vitin 2007 kjo shënon një rritje mbi 320%. Infrastruktura moderne publike do të jetë një themel i fortë i rritjes ekonomike të Kosovës.

Ne, poashtu, kemi filluar të ulim pjesëmarrjen e Qeverisë në ekonominë, për të stimuluar sektorin privat.

Kjo është arsyeje kryesore pse ne po i privatizojmë, sikur shumica dërrmuese e Europës, asetet e shtetit: Post-Telekomunikacionit e Kosovës dhe shërbimin e shpërndarjes së KEK-un.

Si Qeveri, ne gjithashtu po marrim hapa për t'i reformuar politikën fiskale.

Përmes reformave në politikën fiskale kemi ulur normat e tatimeve direkte për 50%, siç është norma e tatimit në fitim të korporatave, që është ulur nga 20% në 10%.

Edhe për tatimet në të ardhura individuale shkalla maksimale është ulur nga 20% në 10%.

## Tashmë i kemi shkallet tatimore më të ulëta në rajon.

## TË NDERUAR PROFESORË E STUDENTË,

Ky vit është viti i vendimeve të mëdha të Qeverisë, për përmirësimin e gjendjes së ekonomisë sonë.

Kompania Amerikano-Turke Bechtel Enka po ndërton autostradën e parë moderne të Kosovës.

Si Kryeministër, jam zotuar për ndërtimin e rrugëve të reja dhe autoudhëve me standarde ndërkombëtare.

Kemi ndërtuar anekënd vendit rreth 600 km rrugë të reja, kemi rinovuar shumë të tjera.

Investimi prej mbi 700 milion euro në rrugën Vërmicë-Prishtinë-Mërdarë që e kemi filluar, ju siguroj se do ta përfundojmë në kohë rekord.

Vetëm nga ky projekt ne po hapim rreth 4000 mijë vende të reja pune.

Dhe ju siguroj se nuk do të ndalemi dhe nuk do të kursejmë për ndërtimin e infrastrukturës moderne rrugore në vendin tonë.

Konsorciumi Francezo-Turk Limak-Aeroport de Lyon e ka fituar të drejtën për ta zgjeruar dhe përmirësuar Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Si rezultat, Aeroporti i Prishtinës do të ofroj shërbime më të mira dhe do të ketë kapacitet më të madh me terminalin e ri.

Gjatë këtij viti, do fillojmë investimet private në ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike.

Ne do të fillojmë projektin energjetik për 24 orë energji elektrike, përmes projekteve madhore të termocentralit Kosova e Re dhe hidrocentralit të Zhurit.

Në krahasim me vitin 2007, kemi deri në 40% më tepër furnizim dhe mbi 13% më shumë prodhim të energjisë elektrike.

## TË NDERUAR STUDENTË, ZONJA DHE ZOTËRINJ,

Arsimi është prioriteti i lartë për Qeverinë time.

Si Kryeministër, ka qenë obligimi dhe përkushtimi im ndaj jush që të ndërtojmë sistemin më modern të arsimit në rajonin tonë.

Dhe këtë jemi duke arritur. Kemi rritur pagat e mësimdhënësve publik universitar për 100%.

Ndërsa, punëtorëve të arsimit filior dhe të mesëm deri në 47%.

Në jemi të vetëdijshëm që kjo nuk mjafton dhe jemi të përkushtuar për të bërë gjithë që është e nevojshme për të vazhduar këtë sukses.

Qeveria ime është e përkushtuar për të ngritur standardin e shërbimit dhe përkujdesjes mjekësore në vendin tonë.

Kemi rritur buxhetin për shëndetësinë.

Kemi përmirësuar furnizimin me barëra esenciale.

Kemi ngritur pagat e punëtorëve mjekësorë deri në 60%.

Por kjo nuk mjafton.

Sepse në disa çështje nuk kemi arritur atë që ju keni pritur dhe atë që ne si Qeveri kemi shpresuar ta arrijmë.

Por përsëri, ne nuk do të ndalemi. Do të vazhdojmë.

Dhe do të ndërtojmë, për të gjithë ne, një sistem shëndetësor modern dhe efikas.

## TË NDERUAR STUDENTË,

Si Kryeministër, unë jam zotuar për një qeverisje efektive, efikase, transparente dhe të hapur.

Qeveria ime ka synuar rritjen e dinamikës së punës, por edhe luftimin e dukurive negative, e korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Qeveria ime, në bashkëpunim me EULEX-in dhe me partnerët të tjerë ndërkombëtarë, po punon për sundimin e ligjit dhe për luftimin e korrupsionit.

Për të ndërtuar sundimin e ligjit, ne po miratojmë ligje për ta thjeshtuar dhe modernizuar kornizën bazike për institucionet tona të sundimit të ligjit.

Poashtu, po punojmë për ndërtimin e një sistemi të drejtësisë me qasje të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Një sistem i cili inkurajon investimet, duke zbatuar kontratat dhe duke inkurajuar zgjidhjen e shpejt të mosmarrëveshjeve, duke i bërë të gjithë të përgjegjshëm ndaj standardeve të njëjta.

## TË NDERUAR STUDENTË,

Ju falënderoj për vëmendje dhe ju ftoj të bëni pyetje; mirëpres diskutimin me ju.





# Në UBT u zhvillua Ceremonia

Në këtë ceremoni studimet bachelor i përmbyllën 280 studentë të katër Fakulteteve: Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Fakulteti për Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci, Fakulteti për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri si dhe Fakulteti për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor.

**Prishtinë, 10 korrik 2010-** Në një ceremoni madhështore, organizuar në sallën "1 Tetori" në Prishtinë, nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), u zhvillua Ceremonia e Diplomimit 2010, në të cilën studimet bachelor i përmbyllën 281 studentë të katër departamenteve: Fakulteti për

Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Fakulteti për Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci, Fakulteti për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri si dhe Fakulteti për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor.

Ceremonia u hap me antonimin e Himnit të Kosovës dhe me parakalimin e anëtarëve të Gardës Ceremoniale të Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe vijoi me fjalën e Presidentit të UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi.

Duke folur para të pranishmëve, prindër, familjarë dhe miq, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, përfaqësues të medieve, profesorë dhe studentë të UBT-së dhe të ftuar të tjerë z.Hajrizi tha: "Ju dëshirojmë mirëseardhje në ceremoninë e përfundimit të studimeve dhe ceremoninë e diplomimit të studentëve të nivelit bachelor në Universitetin për Biznes dhe Teknologji dhe atë për katër fakulteteve: Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Fakulteti për Drejtësi, Shkenca Politike

dhe Diplomaci, Fakulteti për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri si dhe Fakulteti për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor.

Ne jemi shumë të nderuar që ju sot jeni pjesë e kësaj ngjarjeje shumë të rëndësishme, e cila sigurisht është një prej momenteve më të veçanta në jetën e absolventëve tanë.

Kjo ceremoni është si rezultat që del nga një përkushtim i juaj disavjeçar për të studiuar dhe për të ndërtuar një dije dhe një personalitet lideri në njërin prej profesioneve të zgjedhura nga ju, me qëllim të arritjes së një cilësie më të lartë jetësore për ju dhe shoqërinë.

Nevoja për një lider profesional është kërkesë e përditshme kudo në botë, por edhe në Kosovë.

Ne po kërkojmë të zhvillojmë një personalitet, i cili është shumë i përgatitur profesionalisht, është i përkushtuar në punë, ka shkallë të lartë kreativiteti dhe inovacioni, ndërton partneritete me të tjerët, ndihmon veten dhe shoqërinë,

puna e tij bazohet në fakte dhe rezultate, ka një aftësi të lartë ndërkulturore dhe interdisiplinare, por ka edhe një komunikim modern të bazuar në vlerat më të larta.

Studimet në UBT kanë pasur dhe kanë pikërisht një qëllim, që bazohet në atë që thamë: ofrimin e veglave dhe aftësive të nevojshme individit për të marrë vendime racionale dhe që i garantojnë atij suksese dhe vlera që bazohen në standardet më të larta evropiane dhe ndërkombëtare.

Detyra kryesore është që t'ia ofrojmë studentit tonë të gjitha arritjet e fundit në shkencën e menaxhimit, në ekselencën biznesore, në teknologjinë më moderne, në robotikë, në arkitekturë, në dizajn, planifikim hapësinor, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, në integritet evropiane por edhe në kompetencën sociale.

Kjo është mundësuar falë një planprogrami modern që UBT e ka krijuar, duke u bazuar në standardet evropiane dhe amerikane të studimeve por

edhe në bazë të nevojave dhe kërkesave që dalin nga tregu i punës.

Po ashtu, kjo është mundësuar edhe falë angazhimit të një stafi akademik me një eksperiencë të lartë ndërkombëtare në shkencë por edhe në aspektin profesional.

Më shumë se 250 profesorë dhe ekspertë, nga katër kontinente, nga 20 vende dhe kultura të ndryshme, nga rreth 50 e më shumë universitete dhe institucione partnere me renome botërore, po sjellin në UBT përvojën dhe dijen e tyre në këto programe ku ju, të nderuar absolventë, keni studiuar.

Kjo ka krijuar një ambient unik ndërkombëtar, ndërkulturore dhe interdisiplinar jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë.

Kjo i krijon UBT-së mundësinë të ofrojë programe dhe projekte që nuk kanë qenë më parë të pranishme në Kosovë.

Dhe natyrisht kjo ditë e sotme vjen si rezultat i punës së madhe dhe të palodhshme të të gjithëve në UBT, por para së gjithash si rezultat i punës stu-







# monia e Diplomimit 2010



dioze dhe të palodhshme që bëjnë dhe po bëni ju, të nderuar studentë dhe absolventë.

Me angazhimin tuaj të madh, me argumentet e shumta të

paraqitura për nivelin e zhvillimit të UBT-së, mbështetur në programet dhe rezultatet studimore, duke u anëtarësuar në shumë mekanizma ndërkombë-

tarë, ju dhe UBT ia keni dalë të thyeni bllokadën dhe pengesat e shumta, duke u shndërruar në ambasadorë të vendit tonë, për prezantimin e vlerave ekzistuese

dhe synimeve të vendit tonë për të përfaqëuar trendet më bashkëkohore të zhvillimeve në shkencë e teknologji, duke bindur dhe gjithë të tjerët se në Kosovë ka vlera që duhen çmuar e përkrahur dhe duke dëshmuar njëkohësisht se studentët dhe ekspertët kosovarë mund të përfaqësohen denjësisht në të gjitha rrethet kulminante shkencore botërore.

Me këtë ju po ndihmoni vetveten por njëkohësisht po ngrini vlerat dhe cilësinë e jetës në vend.

Dhe ju të gjithë sot meritoni një respekt të veçantë dhe një falënderim të posaçëm".

Me nga një fjalë rasti ceremoninë e kanë përshëndetur edhe Peter Kopacek, Kryetari i Këshillit Akademik dhe ligjërues në UBT, ceremoni e ka përshëndetur zëvendës-presidenti i UBT Derek Shields, ndërsa në emër të Alumnit të UBT-së, ceremoninë e ka përshëndetur Arton Celina.

Pas fjalëve përshëndetëse ka vijuar ceremonia e diplomimit, me dhënie të betimit nga të

porsadiplomuarit dhe me marrjen e certifikatave.

Po kështu, gjatë kësaj ceremonie janë shpallur edhe studentët e dalluar të të katër Fakulteteve e, të cilët janë nderuar me certifikata. Nga Fakulteti Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor u certifikuan këta studentë si Anisa Kryeziu, Adea Gashi, Njomza Havolli dhe Erden Halili, nga Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi janë Ylberina Gashi, Violeta Halili, Berat Thaqi, Kaltrina Bonjaku dhe Ajete Kosumi, nga Fakulteti Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri janë Visar Nura, Vedat Shaqiri, Milot Cakaj, Arlind Nushi dhe Albana Gjinolli, Adelina Shabani, Valbona Dermaku dhe Rexhep Gashi vijën nga Fakulteti Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci.

Manifestimi është përcjellë me pika të zgjedhura muzikore, ndërsa madhësinë atij ia kanë shtuar mysafirët e shumtë, të cilët kanë madhështuar ceremoninë e diplomimit.





Kosova ka mungesë të disa bizneseve

# Studentët e UBT-së të gatshëm për të ndihmuar me ide bizneset

Organizimin e ahengjeve, hapjen e shtëpive private për të moshuar, si dhe hapjen e një dyqani special për shitje të produkteve ushtarake, siç janë flamujt, kapelat, veshmbathjet, por jo edhe armë. Këto biznese i mungojnë Kosovës thanë studentët e UBT-së gjatë prezantimit të biznesplaneve të tyre në UBT



Prishtinë, 13 maj: Për të hapur një biznes duhet punë dhe sakrificë e madhe, mirëpo edhe ide për llojin e biznesit. Për të dhënë ide rreth bizneseve të reja e që në vendin tonë nuk funksionojnë studentët e Universitetit për Biznes dhe Teknologji kanë paraqitur plane pikërisht për këtë. Sipas studentëve të UBT-së shumë biznese nuk funksionojnë në Kosovë sepse nuk ekziston një plan i qartë i biznesit. Ata me planet e tyre kanë paraqitur organizimin e ahengjeve, pastaj hapje të shtëpive private për të moshuar dhe dyqane që shërbejnë në shitje të produkteve ushtarake e shume plane të tjera. Gjatë prezantimit të planeve të biznesit para profesorit të

lëndës përkatëse, Engelbert Selenko dhe disa antarëve të komisionit si prof Edmond Hajrizi dhe disa profesor austriak dhe vendorë. Vendin e parë e zuri projekti "Magic Moments" (Momentet Magjike) që për qëllim kishte organizimin e ahengjeve, projekt në të cilën kanë punuar studentët Mimoza Haliti, Diellza Ademi, Qendresa Sylejmani, Shpresa Zeka, Albina Rrahmani, Erza Dina. Një prej fituesve të këtij projekti Mimoza Haliti thekson se në këtë Biznes plan kanë punuar dy semestra të vitit akademik. "Biznes plani parasheh hapjen e një kompanie që bënë organizimin e ahengjeve nga fillimi deri në fund. Kemi bërë anke-

ta me kompani të ndryshme që merren zakonisht me dekorimin e ambientit të ahengjeve dhe kuptuam se ata e bëjnë këtë biznes vetëm pse duhet të merren me diçka dhe jo pse konsumatorët kanë nevojë të madhe. Kurse konsumatorët ishin shumë të interesuar të ketë një biznes të kësaj natyre sepse kanë shumë kërkesa dhe dëshira që askush nuk mund ti realizoj, thotë Mimoza Haliti Ndërkohë edhe Albina Rrahmani pohon se ky plan parasheh në detaje organizimin e dasmave, mbrëmjet e maturës, ceremoni diplomimi, ditëlindjeve, syneti, përvjetorë të rëndësishëm etj. "Ne ofrojmë mbulesa të tavolinave dhe karrigeve me ngjyra

të ndryshme, dekorime të veturave, tavolinën e nuses dhe dhëndrit, fjongo të ndryshme, dekorim të çokolatave, qirinjtë, ballonat, unazat dhe porta të zbukurara" tha Rrahmani. Ide të tjera siç është plani i hapje të shtëpive private për të moshuar, si dhe hapja e një dyqani special për shitje të produkteve ushtarake siç janë flamuj, kapela, veshmbathje por jo edhe armë. Këto plane të biznesit mund të shitën të ndonjë partner që dëshiron të hapë një biznes të tillë sidomos biznesin për organizimin e ahengjeve. "Nëse pas studimeve nuk kyçemi në biznese familjare ne si grup do fillojmë më këtë biznes për organizimin e

ahengjeve, objektin e kemi të gatshëm që na ka dhuruar prindi i koleges sonë Albinës, objekti është të Liqeni i Batllavës i plotëson të gjitha kushtet për realizimin e planit, por nëse nuk fillojmë më këtë biznes ne kemi menduar ta shesim planin e biznesit", tha Qendresa Sylejmani Nga ana tjetër rektori i UBT-së Edmond Hajrizi ndër të tjera tha se studentët e këtij Universiteti janë ardhmëria e vendit, dhe se lirisht mund të krahasohen me studentet e universiteteve më të forta krejt kjo fal punimeve të shkëlqyera të plan bizneseve që mund të qarkullojnë mjaft mirë në tregun e Kosovës. Për tre grupet fituese UBT ndau certifikata.



Bisedë me Adnan Elshani, Menaxher i Marketingut në kompaninë „Xella Kosova” në Lipjan

# Xella- kompani liderë në botë



Studentë të UBT-së, gjatë një vizite në Xella Kosova

Blokat dhe tullat e fasadës të fabrikës "Xella", padyshim janë material me kualitet të lartë për ndërtimin e shtëpive dhe objekteve të ndryshme, këtë e dëshmojnë testet e bëra lidhur me matjen e parametrev kryesorë si fortësia, simetria, mbrojtja nga zhurma, ruajtës i energjisë dhe tejet i shëndetshëm. Adnan Elshani, Menaxher i Marketingut në kompaninë „Xella Kosova” në Lipjan, flet për UBT News.

**INTERVISTOI:**  
**VEPRIM MUSTAFA DHE**  
**FIDAN BUJUPI,**  
studentë të viti II-të, në UBT

**UBT News: Kush është "Xella Kosova" më konkretisht ?**

**A. Elshani:** "Xella Kosova" me lokacion në Lipjan është pjesë e kompanisë "Xella Internacional" me seli në Duisburg të Gjermanisë, e cila zhvillon aktivitete në 90 fabrika në 20 vende, dhe zhvillon afarizmin tregtar përmes shitjeve në 30 vende. "Xella Kosova" është themeluar në vitin 2003 si degë e "Xella Internacional", ndërmarrje Gjermane, ndërsa aktivitetin e vet në tregun vendor, Maqedonas dhe të Shqipërisë e zhvillon prej vitit 2007.

**UBT News: Sa ka investuar deri më tash në Kosovë fabrika e bllokave "Xella"?**

Investimet kapitale të gjertanishme të Kompanisë "Xella

Internacional" sillen rreth 12 Mil. Euro.

**UBT News: Prej se ka filluar punën "Xella" sa ka mundur të depërtoj në tregun e Kosovës?**

**A. Elshani:** Kualiteti shumë i lartë i prodhimeve silikate të fabrikës "Xella", ka mundësuar që për një kohë relativisht të shkurtë, prej vitit 2007 ato të gjejnë një plasman shumë të mirë. Trendët e rritjes së plasmanit të produkteve tona në tregun Kosovar janë shumë të kënaqshme dhe tendencat e rritjes janë në vazhdimësi.

**UBT News: A mund të na tregoni për kualitetin dhe cilësinë e produktit që prodhon fabrika "Xella"?**

**A. Elshani:** Blokat dhe tullat e fasadës të fabrikës "Xella" janë padyshim material me kualitetin të lartë për ndërtimin e shtëpive dhe objekteve të ndryshme, këtë e dëshmojnë testet e bëra lidhur

me matjen e parametrev kryesorë si fortësia, simetria, mbrojtja nga zhurma, ruajtës i energjisë dhe tejet i shëndetshëm. Përbërja e bllokave është krejtësisht natyrale: rërë silikate, gëlqere dhe uji, kjo mundëson që ambienti i banimit jetë shumë i shëndetshëm. Qetësia dhe komoditeti i banimit me bllokat "Xella" dhe tullat e fasadës është i pakrahasueshëm me materialet tjera ndërtimore.

**UBT News: A ka arritur sadopak "Xella" ta zbus papunësinë në rrethinë dhe sa punëtor ka të punësuar?**

**A. Elshani:** Papunësia e rrethinës ashtu si në tërë Kosovën është shumë e lartë, por përmes kësaj fabrike është arrit që të ardhurat e familjeve të tyre të sigurojnë 45 të punësuar në mënyrë direkte, kurse në mënyrë indirekte janë të angazhuar edhe një numër i konsiderueshëm i të punësuarve përmes kompanive.

**UBT News: A keni ndonjë plan për investime apo tjera gjatë viteve të ardhshme?**

**A. Elshani:** "Xella Internacional" si kompani liderë në botë në lëmin e prodhimit të blloqeve dhe materialeve tjera ndërtimore normalisht që investimet e saj nuk kanë të mbaruar në pjesë të ndryshme të botës. Sa i përket investimeve të mëtejme në Kosovë sigurisht se ato objektiva të kompanisë "Xella" kryesisht janë në lëmin e prodhimeve që përdoren për ndërtimtari. Ne kemi plane që të rrisim kapacitet prodhuese. Ne radhë të parë ideja është e akuzimit të një kompanie ekzistuese në rajon, nëse kjo nuk ndodhe atëherë nuk përjashtohet mundësia e ndërtimit të një fabrike tjetër.

**UBT News: Përveç tregut të Kosovës a eksporton blloka "Xella" edhe jashtë Kosove?**

**A. Elshani:** Përveç tregut të Kosovës "Xella" përmes partnerëve të saj distribuon dhe shet prodhimet e saj edhe në Maqedoni, kurse në tregun e Shqipërisë do të fillojmë së shpejti me aktivitetet tona.

**UBT News: "Xella" ndan donacione dhe bursa për studentë, po për vitin 2011 keni ndonjë projekt të veçantë në këtë planë?**

**A. Elshani:** Kryesisht investimet janë në dhënie e bllokave si donacion për ndërtimin e shtëpive për familjet skamnore në Kosovë. Deri më tani kemi dhënë blloka si donacion mbi 15 shtëpi. Ne ndihmojmë pandërprerë aktivitet rinore dhe të shkollave kryesisht në rajonin e Lipjanit. Ndërsa sa i përket investimeve për shkollim universitar, ajo ndan shpërblime për studentët të cilët prezantojnë ide kreative lidhur me ndërtimin e objekteve me bllokat "Xella".



UBT organizoi konferencën "Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe hulumtimet për paqe"

# Kosova drejtë OKB-së

"Rusia do bëjë çmos për të penguar një gjë të tillë megjithatë, Kosova dhe partneret e saj duhet punojnë për të siguruar një numër më të madhe të njo-hjeve me qëllim që të sigurohen 2/3 e shteteve anëtare të OKB-së të cilat e njohin Kosovën dhe në këtë rast gjërat mund të ndryshojnë pozitivisht lidhur me anëtarësimin e vendit tuaj në OKB", këto deklarime i bëri Dr. Nakamura profesor i Universitetit Bunkyo-Tokio, gjatë konferencës ndërkombëtare të mbajtur në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në Prishtinë

## Prishtinë, 25 gusht:

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Prishtinë, në vazhdim të organizimit të konferencave me karakter ndërkombëtar, ka organizuar dhe sot përmbylli punimet e konferencës shkencore me temën "Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe hulumtimet për paqe". Konferenca e iniciuar nga profesorë dhe studentë të Fakultetit për Menaxhim, Biznes dhe Ekonomi të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), në bashkëpunim edhe me profesorët e studentët e Universitetit Bunkyo-Tokio në Japoni, mblodhi ekspertë dhe profesorë të kësaj fushe nga institucionet ndërkombëtare, partnerë të UBT-së, si dhe ekspertë vendorë të kësaj fushe.

Punimet e Konferencës i hapi Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Presidenti i UBT-së, i cili ju shprehi mirëseardhje të pranishmëve. Po ashtu të pranishmit i përshëndeti edhe zëvendës-presidenti i UBT, Derek Schields.

Ndërkohë z. Sami Ukelli, Ambasador i Republikës së Kosovës në Japoni, me seli në Tokio, i përshëndeti të pranishmit e konferencës dhe falënderoi shtetin dhe popullin Japan për njohjen e pavarësisë së Kosovës si dhe bashkëpunimin e mëtutjeshëm dhe të vazhdueshëm ndërshtetëror.

Konferenca i zhvilloi punimet në tri sesione, në të cilat u prezantuan një varg të arriturash nga hulumtimet shkencore të



pjesëmarrësve të konferencës.

"Kosova si pjesë e Ballkanit perëndimor natyrisht që si synim kryesor ka anëtarësimin në Bashkimin Evropian megjithatë anëtarësimi në BE kërkon njëkohësisht edhe angazhim maksimal të institucioneve të Kosovës. Në të njëjtën kohë edhe Bashkimi Evropian duhet të definojë qartë politikën e vet karshi Kosovës e cila në fund do të konkludohet edhe me marrëdhënie kontraktuale. Gjithashtu është shumë e rëndësishme të potencohet edhe aspekti i bashkëpunimit rajonal si një kriter që duhet të plotësohet paraprakisht", tha Prof. Dr. Alex Standish, Ekspert për Ballkanin Perëndimor, gjatë punimit të tij "Kosova dhe Ballkanit Perëndimor".

Ndërsa Prof. Nakamura nga Universiteti Bunkyo – Tokio foli lidhur me procedurat e anëtarësimin në OKB dhe ritheksoj edhe njëherë rëndësinë që ka anëtarësimi në këtë organizatë për Kosovën. Ai po ashtu shtoi se ashtu si qëndrojnë gjërat tani për tani:

"Rusia do bëjë çmos për të penguar një gjë të tillë megjithatë, Kosova dhe partneret e saj duhet punojnë për të siguruar një numër më të madhe të njo-hjeve me qëllim që të sigurohen 2/3 e shteteve anëtare të OKB-së cilat e njohin Kosovën. Në këtë rast gjërat mund të ndryshojnë pozitivisht lidhur me anëtarësimin e Kosovës në OKB", tha Prof. Nakamura nga Universiteti Bunkyo-Tokio, Profesor Afrim Hoti foli lidhur më procesin e shtetformimit të Kosovës dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet Kosova. Ai gjithashtu nënvizoi se opinioni GJND-ës është një avantazh të cilin institucionet e Kosovës duhet ta shfrytëzojnë lidhur me avancimin e procesit të lotimit.

## KOSOVA KA RESURSET NJERËZORE DHE FAKTORIN NJERI

Po ashtu në sesionin e dytë u paraqitën ekspertë nga lëmia e ekonomisë. Prof. Dr. Musa Limani tha se Kosova në aspektin ekonomik po ballafaqohet me disa probleme që janë evidente për vendet në tranzicion por që dy vite Kosova ka gëzuar shtetin e vet dhe në aspektin ekonomik ka shenja pozitive dhe të arritura por që jemi në pritje të investitorëve nga shtete tjera edhe më shumë, "Kosova ka dy faktorë shumë të rëndësishëm atë resurset njerëzore dhe faktorin njeri" tha prof. Limani.

Barack Obama, Presidenti i SHBA-ve, shprehu vendosmërinë e tij për të krijuar një botë pa armë bërthamore. "Një ndër prezantimet ishte edhe historia e Japonisë në Luftën e Dytë Botërore, për Hiroshimën dhe Nagasakin dhe datën 6 gusht, të cilën japonezët e kujtojnë si një ngjarje fatkeqe dhe bëjnë thirrje që të mos përsëritet më. "Edhe pse ka lënë pasojë shumë të mëdha, bomba atomike në vendin tonë dhe ende po vazhdojnë pasojat, ne jemi për ta vazhduar jetën, dhe jemi kundër bombave, që të ketë sa më shumë paqe të njerëzimi dhe

Barack Obama, Presidenti i SHBA-ve, shprehu vendosmërinë e tij për të krijuar një botë pa armë bërthamore me një lidhësi të fortë", than studentët Junki Toi, Mai Arisaka, Yuma Ishikawa nga Universiteti Bukyo – Tokio. Për kulturën japoneze dhe jetën studentore në Japoni folën studentët po të universiteti në fjalë si, Monami Uchida, Yuka Sato, Kana Inugai.

Rina Dizdari dhe Besiana Behluli studente në UBT-MBE anglishte, në UBT prezantuan temën "Historical and Political Overview of Kosovo", "Rishikim i ngjarjeve historike dhe politike të Kosovës".

Në temë ajo përmbledhi të gjitha ngjarjet më kryesore dhe

të rëndësishme gjatë dy dekadave të fundit, qysh nga viti 1989, kur situata politike në Kosovë ishte tensionuar me shumë, vitin 1998, luftën e fundit në Kosovë, përjetimet e popullit. Gjithashtu, dhe vitet e pas luftës në Kosovë, kohës në tranzicion, ndryshimet e mëdha që pasuan në jetën e përditshme, dhe tani jetën pas pavarësisë së vendit, ku populli duhet të ballafaqohet me shume sfida po ashtu dhe mundësi dhe dyer të reja që pavarësia ua ofron. "Pavarësia e Kosovës kishte një kuptim të rëndësishëm për çdo qytetar: një mësues, student, bujk, presidenti, etj Ajo hapi dyer të reja dhe mundësi, për çdo njërën prej tyre. Për ne si studentë, si dhe për gjeneratat tona, kjo do të thotë se ne mund të paraqesim vendin tonë në çdo ngjarje ndërkombëtare, dhe të përpiqemi për të përfaqësuar atë me përgjegjësi më shumë dhe krenari. Kjo do të thotë shumë punë dhe sakrificë në rrugën tonë drejt BE-së. Kjo do të thotë shpresë për një të ri dhe jetë më të mirë" tha Rina Dizdari "Ne duam të falënderojmë Japoninë për njohjen e Kosovës si një shtet të ri dhe të pavarur. Dhe ne shpresojmë se do të forcojmë marrëdhëniet tona, nëpër universitetet tjera, dhe duke punuar së bashku dhe duke vizituar së shpejti vendin tuaj të bukur" shtoi ajo.

## UBT-JA MË PËRGATITI TË KYÇEM NË BOTËN E BIZNESIT

Po ashtu Ylberina Gashi studente në UBT, foli për jetën studentore në Kosovë, pikërisht në Prishtinë. "Ne njihemi si një popull me një rini të dendur dhe pjesa më e madhe e kësaj rinie është e përkushtuar drejt një edukimi dhe një jete me të mirë për të ardhmen. Mangësi për studentet është fakti që mundësitë universitare më të avancuar gjenden në Prishtinë, dhe të gjithë ata që

gjenden në qytete apo vende tjera janë të obliguar të udhëtojnë dhe të mbijetojnë në Prishtinë për ti përfunduar studimet. Për të jetuar në Prishtinë një student duhet të ballafaqohet edhe me jetën e shtrenjte që zhvillohet në këtë qytet. Përparësi të madhe kanë ata studentët që kanë sukses të punësoshme dhe të kryejnë shkollimin në të njëjtën kohë, gjë që gjejnë një lehtësim për të vazhduar me tutje" shtoi Ylberina Gashi.

Pikat tjera të përmendura në prezantim ishin edhe akomodimi i studenteve, ata kanë mundësi të udhëtojnë çdo ditë për në Prishtinë apo të vendosen qoftë në konvikte apo banesa private.

UBT është një Universitet që ofron mundësi zgjedhesh për studentet. Ata mund të studiojnë në gjuhën shqipe me ligjëruese s vendor apo të studiojnë në gjuhë të angleze me staf ndërkombëtar. Unë isha pjesë e studimit ndërkombëtar dhe mund të them bindshëm që të kesh mundësi të jesh pjesë e profesorëve aq profesional që vijnë nga Evropa, Amerika dhe është privilegj i jashtëzakonshëm si për mua dhe kolegët e mi. Ata gjithë përvojën e tyre qofte profesionale apo jetësore e kanë ndare me ne dhe janë munduar te na përgatisin për botën e biznesit duke na dhenë këshilla si të veprojmë në raste të caktuara, gjë që ndikon për të ardhmen tone. Jam shumë e lumtur që pata mundësi të mësoj aq shumë gjëra nga këndvështrime të ndryshme dhe mendoj se ndihem e përgatitur të hyj në botën e biznesit dhe të kyçem profesionalisht në atë drejtim" përfundoi ajo.

Konferenca "Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe hulumtimet për paqe" është konferenca e dytë shkencore ndërkombëtare e organizuar nga UBT.



Për herë të pestë

# UBT-ja organizoi videokonferencë ndërkulturore

"Dy çështje shumë të rëndësishme që u cekën gjatë videokonferencës ishin se ekonomia e Japonisë në dhjetë vitet e fundit ka shënuar një ngadalësim të dukshëm dhe çështja e natalitetit që ka shënuar rënie drastike ku në të ardhmen parashihet krizë në shtetin e Japonisë në mungesë të popullatës së re", u tha gjatë videokonferencës të mbajtur sot në UBT

**Prishtinë, 21 maj:**

Në vazhdim të ngjarjeve dhe konferencave me karakter ndërkombëtar, të organizuara në vazhdimësi nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Prishtinë, ky universitet sot ka organizuar për herë të pestë Videokonferencën ndërkombëtare me temën në vazhdim



"Kompetencat ndërkulturore".

Konferenca është organizuar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Prishtinë në bashkëpunim me Universitetin Bunkyo-Tokio në Japoninë.

Organizatorët e Video-konferencës ishin prof. Yuko Ikuta, nga Fakulteti për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Bunkyo University dhe prof. Fatbardha Osmani, nga UBT-ja dhe bashkëpunëtore, përkatësisht

pjesë e hulumtimit të cekur më lartë, dhe studente e dy Universiteteve në fjalë.

Në kuadër të konferencës Kompetencat ndërkulturore në tre prezantimet e para u fokusuan mbi temën mes Japonisë, Kores Jugore dhe Kinës. Studentët e dy universiteteve dhanë shumë informacione rreth luftës së ftohtë dhe pasojat e tanishme që kanë dalë nga këto ngjarje të rëndësishme.

Dy çështje shumë të rëndësishme që u cekën gjatë videokonferencës ishin se ekonomia e Japonisë në dhjetë vitet e fundit ka shënuar një ngadalësim të dukshëm dhe çështja e natalitetit që ka shënuar rënie drastike ku në të ardhmen parashihet krizë në shtetin e Japonisë në mungesë të popullatës së re.

Kjo konferencë dhe konferenca e radhës do të jenë të incizuara nga universiteti Bunkyo si pjesë e

një hulumtimi me UBT me temën përdorimi i gjuhës angleze su LINGUA – FRANGA mes dy popujve të ndryshëm.

Më pas njëri nga studentët me anë të kërcimit e performoi një art parcial të quajtur IA, i cili paraqet një simbol të kulturës japoneze.

"Kjo është konferenca e pestë me radhë ku kemi arrit bashkëpunim të ngushtë në mes dy kampuseve. Përmes kësaj konference studentët po arrin të informohen dhe t'i rrisin njohuritë e tyre në dy aspekte si për gjuhën ashtu edhe marrjen e informatave për shtetin dhe kulturën e Japoneze" përfundoi prof. Qehaja-Osmani

Videokonferenca i vazhdon punimet në javën që vjen (më 28 maj 2010) në UBT. Po ashtu në fund të konferencës u fol se palët nga Japonia si studentët dhe profesorët që janë pjesë e hulumtimit, do vijnë në Kosovë për vazhdimin e punimeve dhe u vendos se në fund të muajit gusht po të këtij viti konferenca do mbahet në UBT.

Videokonferencën me karakter ndërkombëtar dhe shkencorë, për herë të parë në vend dhe në rajon, e ka organizuar i vetmi Universitet privat në Kosovë, UBT-ja.

## Studentët e UBT-së vizituan fabrikat e Pejës



Prishtinë, 31 maj: Studentët e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), përkatësisht departamentit për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, kanë vizituar fabrikat për prodhimin e lëngjeve, ujit dhe kafes në qytetin e Pejës, siç janë "Birra Peja", "Devolli Company" dhe "Ujë Rugove".

Studentët e UBT-së në shoqëri të profesorëve Urgan Alija dhe Afrim Ademi janë pritur nga menaxheret e kompanive në fjalë.

Drejtues të birrarisë "Birra PEJA" të pranishmit i kanë njoftuar me procesin e prodhimit të birrës, numrin e punëtorëve si dhe

shtimin asortimentit të prodhimit me ujën akull i cili ka përfshirë mbi 80% të tregut vendor. Nga ana tjetër në "Devolli Company," studentët patën rastin ta shohin procesin e prodhimit të qumështit VITA dhe lëngjeve Tango si dhe përpunimin e kafes "Princ caffè". Gjatë ditës studentët e UBT-së vizituan edhe fabrikën e "Ujë Rugove", ku ndër të tjera patën rastin ta vizitojnë burimin e ujit Rugova dhe procesin e prodhimit.

Birra Peja, Devolli Company dhe Ujë Rugove, janë të njohura në tregun vendor dhe evropian për kualitetin e tyre të lartë.



Studentët e UBT-së vizituan Ferronikelin

# Mirësevini në Gjigantin e Kosovës për punësim



**Prishtinë, 17 maj:** Studentët e Fakultetit të Mekanikës në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), bashkërisht me prof. Bekim Gashi dhe prof. Bertan Karahoda, të martën kanë vizituar gjigantin Ferronikelin në Drenas, ku janë njohur me zhvillimin e saj që nga fillimi i punës, procesin e privatizimit e deri në ditët e sotme. Drejtori i zyrës Ligjor, z. Shaban

Bujupi dhe znj. Kadrie Sminica, shefe e elektroteknikes në departamentin e Konavtorëve, i kanë njoftuar studentët se Kompania ka filluar punë në vitin 1985, në vitin 2006 privatizohet dhe sot ka një numër të mirë të punësuar mbi 400 kontraktor dhe 1020 të angazhuar, ku në mesin e tyre ka të punësuar që kanë përfunduar studimet në UBT si menaxherë të sektorëve të

ndryshëm. "Bartja e xehes ose lënda e parë, bartet me vagona nga Qikatova dhe Medveci, e cila grumbullohet e përzihet e shkon në shiritat transportuese dhe përmes shiritave shkon në furrë rrotulluese", tha znj. Kadrie Sminica, shefe e elektroteknikes në departamentin e Konavtorëve në Ferronikel. Gjithashtu ata u njoftuan më për së afërmi edhe me sektorët

dhe nësektorët e kompanisë në fjalë siç janë: Sektorin e minierave, të shkrites ose i prodhimit dhe ne detaje u njoftuan për sektorin e furrave rrotulluese ku përzihet xehja me temperaturë 500 deri në 800 grad, për pultin komandues ku përmes kësaj dhome kontrollohet e tërë kompania në fjalë, për sektorin ku bëhet testimi i tyre dhe laboratorin i kimisë ku shërben për analiza dhe ngrohtoren e objektit në tërësi dhe për sektorin e administratës dhe historiatin e kompanisë. Gjatë kësaj vizite drejtori Shaban Bujupi, i ka falënderuar studentët e UBT-së për vizitën e bërë dhe ndër të tjera i ka njoftuar edhe me objektivat zhvillimore dhe aktivitetet vepruese që Ferronikeli do t'i ketë në periudhën vijuese konform planit të tyre.

Kompania Ferronikël prodhon nikel dhe hekur, është e njohur për eksportin e vet dhe kualitetin e tyre të lartë në Evropë dhe më gjerë. Studentët ditë më parë kanë vizituar fabrikën për prodhimin e produkteve ndërtimore "Xella Kosova" në Lipjan, ku janë pritur nga drejtori i prodhimit Agim Ramadani dhe i tërë menaxhmenti i kompanisë në fjalë. Ndryshe kompaninë Ferronikel në Drenas, e cila numërohet si ndër kompanitë më gjigante në vend dhe e privatizuar qysh në vitin 2006 nga AKM, e cila prodhon dhe eksporton nikel, hekur e produkte tjera. Nga kjo vizitë studentët e UBT-së mësuhan që me anë të automatizimit (teknologjisë), procesi i prodhimit të nikelit dhe produkteve tjera është shumë më e lehtë dhe më e efektshme.

## Vlerat e UBT-së u prezantuan në Universitetin e Salzburgut



**Prishtinë, shtator 2010** - Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe Prof. Lulzim Beqiri, kanë qëndruar në Salzburg të Austrisë për gjashtë ditë me radhë, në një vizitë studimore, si pjesë e projektit TEMPUS. Qëllimi i vizitës ka qenë njohja me strukturën organizative të Universitetit të Salzburgut në aspektin akademik dhe administrativ, me fokus të veçantë në Zyrën për sigurimin e cilësisë. "Gjatë kësaj vizite UBT pati rastin të përfitojë nga shkëm-

bimi i përvojave me Universitetin e Salzburgut dhe gjithashtu të prezantojë vlerat e UBT-së," tha Lulzim Beqiri, profesor në UBT. Gjithashtu, vizitat janë përcjellë me takime dhe prezantime nga zyrtarët më të lartë të Universitetit të Salzburgut. Gjatë kësaj vizite, delegacioni nga Kosova, që përveç UBT përbëhej edhe nga disa përfaqësues tjerë të BPrAL, ka pasur mundësinë të vizitojë pjesën më të madhe të fakulteteve dhe institucioneve në kuadër të Universitetit në fjalë,

duke përfshirë edhe bibliotekën universitare në të cilën gjinden ekzemplar të librave nga shekulli VIII. Universiteti i Salzburgut është themeluar në vitin 1622 dhe financohet nga fondet publike, por ka fonde edhe nga projekte të ndryshme, si p.sh., nga hulumtimet dhe projektet nga EU. Momentalisht Universiteti i Salzburgut ka rreth 17.000 studentë, në katër fakultete, ndërkaq nga Kosova në këtë universitet studiojnë tre studentë.



Bisedë me Prof. Schari Zafarpour, ligjërues në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT

# UBT - Universitet udhëheqës në rajon

Jo pse jam tanimë unë pjesë e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), por me të vërtetë ky universitet është i rangut të lartë dhe sigurisht në pozitë të mirë me standardet ndërkombëtare. Prof. Schari Zafarpour, flet për gazetën UBT News.



**UBT News: Cila ka qenë arsyeja që ju të angazhoheni si mësimdhënës në vendin tonë më saktësisht në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi?**

**Prof. Zafarpour :** Pas takimit që pata me presidentin e UBT, Prof. Dr. E. Hajrizi më ftoi që të mbajë një fjalim në UBT në shkurt 2006. Unë kam qenë me të vërtetë impresionuar në lidhje me standardet e cilësisë së UBT-së. Unë kam dhënë ligjërata në shumë vende si në Vjenë, Krems, Eisenstadt (Austri), UCLA dhe USC (USA), Zagreb, Opatia (Kroaci), Prag (Cech

Republika), Ish-ën-krahinë (Francë), Napoli (Itali), UST në Tajlandë, në Kiev Ukrain, Shkup (Maqedoni), etj, po tash së fundi edhe në UBT dhe UBT për nga cilësi dhe standarde krahasohet me universitete më prestigjioze të ndryshme në kontinent.

**UBT News: Po cilësia momentale e UBT-së?**

**Prof. Zafarpour :** UBT mund të krahasohet standardet e cilësisë në mes të universiteteve të ndryshme dhe shteteve, jo pse jam tanimë unë pjesë e UBT-së por me të vërtetë ky universitet është i rangut të lartë dhe sigurisht në pozitë të mirë me standardet ndërkombëtare.

Unë jam shumë i impresionuar për mikpritjen dhe mentalitetin miqësor të kulturës të Kosovës.

**UBT News: Si e vlerësoni nivelin e studentëve në UBT?**

**Prof. Zafarpour :** Cilësitë e studentëve janë çdokund të njëjta dhe është e vlefshme edhe për UBT, 80% janë të motivuar dhe të interesuar kurse 20% jo dhe aq.

**UBT News: Si e shihni të ardhmen e këtij institucioni?**

**Prof. Zafarpour :** Unë jam shumë optimist dhe i sigurt se UBT do të bëhet Universitet udhëheqës në rajon, sepse Presidenti Prof.

Hajrizi ka bërë hapa të drejtë për përmirësimin e programeve mësimore, aktiviteteve hulumtuese për anëtarë të fakultetit dhe në strukturën administrative. Cilësia e programeve mësimore është e lidhur me cilësinë e hulumtimit të rezultateve për të gjithë studentët e fakultetit, që janë standarde ndërkombëtare.

**UBT News: Sfidat më të madhe për vendin tonë, me përjashtim të zhvillimeve politike, mbetet zhvillimi ekonomik. Çfarë mund të bëhet në këtë drejtim?**

**Prof. Zafarpour :** E vetmja mënyrë e drejtë për t'u krahasuar me Evropën është të

mbështeten kompani të vogla dhe të mesme nga qeveria. Kjo do të thotë për ta bërë atë të mundur (Komuniteti Ndërkombëtar në Kosovë) të ketë një qasje në kapitale të lira për kompanitë (Kjo është minimale nga ajo që komuniteti ndërkombëtar duhet të bëjë për Kosovën).

**UBT News: Cilat janë perspektivat tuaja të popullit të Kosovës?**

**Prof. Zafarpour :** Shumë miqësor dhe ndihmues.

**INTERVISTOI:  
ERZA DINA  
DHE SHPRESA ZEKA,  
STUDENTE TË VITI III-RË, NË UBT**



## Xella Kosova LLC

# Shekulli XXI dhe Energjia Efiçente në shtëpitë, objektet shumëfamiljare dhe objektet tjera.

Sfidat e shumta që po e karakterizojnë këtë mijëvjeçar në fushën e energjisë që në fillim të tij, një pjesë janë nga mijëvjeçari që e lamë pas për shkak të mos shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, ndërsa pjesa tjetër është për shkak të mos shfrytëzimit efficient të energjisë në epokën në të cilën po jetojmë gjenerata jonë.

Me rritjen e zhvillimit ekonomik në përmasa globale, edhe konsumi i energjisë ka shënuar ngritje të shpejtë, andaj para botës është paraqit sfida e shfrytëzimit racional të energjisë elektrike që njihet me termin Efiçienca e shfrytëzimit të Energjisë.

Varsisht prej burimeve energjetike në botë, sasisë e tyre janë të limituara, në bazë të përlogaritjeve bëhet fjalë për rezerva të përgjithshme edhe për 50 vite.

Për këtë kërkohet vigjilencë se si të shfrytëzohet energjia sa më me efiçiençë kur dihet se kërkesat për të vazhdimisht janë në rritje.

Direktiva Evropiane lidhur me performansën e ndërtesave e njohur si EPBD (European Performance Building Directive) ka të bëjë me reduktimin e shpenzimeve të energjisë e cila aktualisht sille mbi 30% për ngrohje dhe ftohje të objekteve, pa llogaritur aparatat që janë në dispozicion në çdo familje.

Për këtë janë vënë edhe kufizimet kohore lidhur me reduktimin e shfrytëzimit të energjisë deri në vitin 2020, reduktimin e CO<sub>2</sub>, dhe rritjen e sasisë së energjisë së prodhuar nga burime alternative.

E tëra kjo njihet si:

- 20% konsum për objekte,
- 20% emitim të CO<sub>2</sub> dhe
- +20% Energji të ripërtirshme.

Kosova është ende larg integritimeve të mirëfillëta Evropiane, mirpo edhe ne duhet të fillojmë të bëjmë hapa të vegjël në këtë drejtim sepse me këtë kursejmë burimet tona energjetike, plotësojmë kriteret të kërkuara nga BE-ja dhe familjet tona shpenzojnë më pak energji apo e shfrytëzojnë atë më me efiçiençë.

Si të arrihen këto?

Xella Kosova LLC pjesë e koncernit Xella Internacional me seli në Gjermani posedon ekip të çertifikuar në Gjermani nga Instituti DEKRA lidhur me Energjinë Efiçiente.

Ekipi i Xella Kosova i cili u çertifikua në Gjermani për Energjinë Efiçiente po ndihmon dhe do të ndihmojë në të ardhmen të gjithë klientët të cilët ndërtojnë objektet e tyre me bllokat Xella, se si Shtëpia apo objekti i tyre të shpenzojë më pak energji për ngrohje gjatë dimrit dhe për freskim gjatë verës.

Kjo do të jetë e mundur nëse na konsultoni, apo merri informata nga projektuesi kur ju të planifikoni të ndërtoni objektet tuaja, të dedikuara për banim apo për aktivitete tjera të çfardo natyre qofshin ato. Varsisht nga materiali që përcaktoheni të ndërtoni

shtëpin apo objektin tuaj, pozitën dhe shumë faktorë tjerë, ne do tju ndihmojmë që shtëpia juaj të ketë nevojë për më pak energji për ngrohje dhe ftohje.

Prandaj është me rëndësi parësore që për cilësinë e materialit për ndërtim (bllokat) dhe për aftësinë e tij për të ruajtur energjinë të konsultoheni me Inxhinier të ndërtimtarisë, ngase me këtë kurseni para. Nga përvoja jonë vërejmë se të gjitha gjërat në shtëpitë tona janë të lëvizshme, dhe herë pas here ne i ndërrojmë ato (sofa, mobilje, kuzhina, dritare, dyer etj) por pjesën e fortë të objektit nuk mundemi ta ndërrojmë, prandaj duhet të kemi shumë kujdes kur përcaktohem se me çfarë blloqesh do të ndërtojmë, sepse ato janë të pandrueshme.


- Bazuar në kualitetin shumë të lartë, dhe specifikat teknike që plotësojnë bllokat Xella – Silka vijmë në përfundim, se të ndërtohet shtëpinë apo objektin tuaj me bllokat Xella – Silka do të thotë se ke bërë zgjidhje të menqur dhe shumë afatgjate sepse janë shumë faktorë që flasin në favor të kësaj që u tha më lartë:

- Komoditeti i banimit
- klima e brendshme (përbërje krejtësisht natyrale – rërë kuarci, gëlqere dhe ujë)
- Ruajtës i energjisë,
- Mbrojtësi më i mirë nga zhurma
- Simetria e rregullt e bllokave – bllokat më të saktë në dimensione.
- dhe shumë argumente tjera.

Në aspektin termoizolues deri më tani asnjë bllok nuk mund të sigurojë termoizolim të mjaftueshëm pa përdorimin e një shtrese të izolimit.

Bllokat Xella – Silka me një shtresë termoizolimi janë zgjidhja më e qëlluar për të aplikuar energjinë efiçiente në shtëpitë tuaja, sepse kanë aftësitë më të mira ruajtëse të enërgjisë.

Përmes këtij diagrami shihet qartë se ruajtja e Enërgjisë me një shtresë termoizoluese me bllokat Xella - Silka është zgjidhja më e mirë në krahasim me të gjitha llojet e bllokave.




HUMBJET E ENERGISË NË NJË SHTËPI



OBJEKT I NDERTUAR ME BLOKA XELLA-SILKA



OBJEKT ME NJË SHTRESË IZOLIMI NDËRTIMI I VRAZHDË ËSHTË KRYER ME XELLA - SILKA



DIAGRAMI I RUAJTJËS SË ENËRGJISË ME BLOKA TË NDRYSHËM

Do shtëpi? Zgjedh cilësi.

[www.kosova.xella.com](http://www.kosova.xella.com)

xella

silka



UBT-ja fillon bashkëpunimin me Kroacinë

# Fillon bashkëpunimi me Universitetin e Rijekës

**Prishtinë, 6 shtator:**

Në kuadër të marrëveshjeve të shumta që i ka Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), me universitetet e tjera më prestigjioze në Evropë dhe Botë, Presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe dekanit të Universitetit të Rijekës, Prof. Dr. Joze Piric, nënshkruan memorandumin e mirëkuptimit ndëruniversitar për të vazhduar bashkëpunimin shkencor dhe kulturor në mes dyja Universiteteve.

"UBT ka qenë gjithherë aktive në ofrimin e mundësive dhe bartjeve të dijeve nga universitetet të njohura botërore me anë të marrëveshjeve dhe të bashkëpunimeve. Dhe një marrëveshje të tillë e kemi filluar edhe me Universitetin e Rijekës, i cili do të na mundësojë shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve të organizojmë seminare dhe takime tjera akademike për çështje shkencor, zbatimin e përbashkët të programeve postdiplomike, aktivitetet lidhur me kurset verore dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet", theksoi Presidenti i UBT, Edmond Hajrizi, gjatë takimit me palët nënshkruese. Sipas palëve nënshkruese



bashkëpunimi ndëruniversitar në mes UBT dhe Universitetit të Rijekës ka filluar edhe më herët dhe pohuan se mar-

rëveshja është incizuar nga të dy palët.

Në bazë të bisedave që patën mes udhëheqësit e

institucioneve në fjalë Presidenti i UBT-së Dr. Hajrizi, u nda i kënaqur me të arritura e Universitetin e Rijekës, sido-

mos më programet e studimit më teknologjinë më moderne, me stafin akademik dhe me arritjet e studenteve.

## Nazmi Zeqiri botoi librin për investime

**Prof. Nazmi Zeqiri botoi librin për ndikimet e investimeve të huaja në vendet në tranzicion**

Nazmi Zeqiri, ligjërues në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), publikoi librin e tij të parë "Investimeve e Huaja Direkte në vendet në tranzicion".

Në këtë libër autori ka publikuar punën e tij hulumtuuese, ku fokusi kryesor ka të bëjë me ndikimet e investimeve të huaja direkte (IDH) në vendet në tranzicion dhe një analizë krahasuese për ndikimin në vende të ndryshme që vjen si rezultat e politikave të ndryshme.


Aspektet i veçantë në librin "Investimeve e Huaja Direkte në vendet në tranzicion", i kushtohet ndikimeve të provuara në shumë aspekte të zhvillimit ekonomik si: rritja e

outputit vendor, rritja e punësimit dhe pagave, produktivitetit, transferimin e teknologjisë dhe krijimit të lidhjeve dhe rrjeteve biznesore të ndërmarrjeve vendore me ato ndërkombëtare. Nuk mungon gjithashtu edhe analiza e procesit të privatizimit në këto vende që padyshim ka qenë një nxitës i madh dhe atraktivitet për investimet e huaja. Në dekadën e fundit, qarkullimet ndërkombëtare të kapitalit kanë marrë epërsinë në drejtimin e tregtisë së jashtme, duke u bërë fuqi kryesore përtej ekonomisë botërore. Në këtë kontekst Investimet e Huaja Direkte (IHD) kanë luajtur një rol vendimtar. Ky rol është shumë i rëndësishëm në modernizimin e vendeve në zhvillim, si dhe në trans-

formimin e vendeve në tranzicion ku formimi i kapitalit privat është i domosdoshëm. Prandaj, nuk duhet habitur pse në shumë vende janë duke ofruar stimulime preferenciale për kompanitë e huaja që dëshirojnë të investojnë në vendet e tyre. Kjo ishte dhe është e pranishme sidomos në vendet në tranzicion, ku stimulimet preferenciale për investimet e huaja ishin ofruar nga pothuajse çdo vend. Shkaku kryesor prapa këtij qëndrimi konvencional janë IHD (në mungesë të kapitalit vendor përshpejtojnë procesin e transformimit nga ekonomitë e komanduara në ekonomi të tregut. Duke analizuar Investimet e Huaja Direkte mund të thuhet se ato padyshim kanë luajtur

dhe luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik në shumicën e vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Rëndësia e investimeve të huaja është edhe më e madhe për vendet në tranzicion, ku kapitali vendor është i paafte të përmbushë nevojat e investimeve të mëdha të ekonomisë në procesin e transformimit nga ekonomia e komanduar në ekonomi të tregut. Edhe pse është ende herët për të provuar në dhënien e një vlerësimi të përgjithshëm të ndikimit të IHD në vendet në tranzicion, tendencat e fundit në disa vende të zhvilluara në tranzicion demonstrojnë se Investimet e Huaja Direkte mund të luajnë një rol vendimtar në zhvillimin e tyre. Teoria

në përgjithësi i njeh IHD si një faktor kyç në tranzicionin integruar të ekonomive në tranzicion në ekonominë botërore dhe në mbështetjen e konvergencës ekonomike.





# Bashkëpunimi student-polici i kënaqshëm

Statistikat e policisë tregojnë se nga muaji janar deri në muajin qershor të këtij viti janë sekuestruar 20 kilogram heroinë, 56 kilogram marihuanë, 700 bimë kanabis, ku krahasuar me vitin 2009 rezulton që sasia e lëndëve narkotike të sekuestruara të jetë dukshëm më e madhe

**FLAMUR SADRIU,**  
STUDENT I VITIT I NË UBT

Edhe vetë studentët dhe të rinjtë, kanë rolin e tyre në parandalimin e transportit dhe përdorimit të lëndëve narkotike. Këtë mund ta bëjnë sidomos duke bashkëpunuar me Policinë e Kosovës.

"Përveç lëndëve mësimore ne shpesh debatojmë për tema nga jeta që na rrethon, po flas për studentët e UBT-së, dhe një ditë biseduam për parandalimin dhe mos pirjen e drogës. Të gjithë kemi qenë kundër dhe sa më larg ndaj saj dhe të gjithë ishim të mendimit se për parandalimin e drogës me doemos duhet me bashkëpunuar me Policinë e Kosovës", tha Lirigzona Morina studentë në UBT. Kurse Lirije Muja thotë, "100% e studentët nuk përdorin lëndë narkotike por studentët janë të obliguar t'u ndihmojnë organeve përgjegjëse për ta parandaluar këtë dukuri, studentët primarë e kanë mësimin dhe shkencën, ata të cilët mirren me drogë nuk janë studentët", tha Lirija.

Zëdhënësi i PK-së, Baki Kelani thotë se ndihma që studentët mund të japin në parandalimin e kësaj dukurie është përmes informimit dhe bashkëpunimit me Policinë e Kosovës. Ai thotë se PK-ja po punon që të ngrish nivelin e bashkëpunimit me studentët.

"Kryesisht studentët dhe të gjithë nxënësit e shkollave të ndryshme mund të ndikojnë shumë në parandalimin e kësaj dukurie negative duke informuar dhe bashkëpunuar me Policinë e Kosovës në mënyrë që efekti i reagimeve policore në raste të tilla të jetë më i shpejtë dhe më i suksesshëm në bazë të informacioneve që studentet mund ti japin policisë. Mund të themi se deri tani kemi një bashkëpunim të mirë me nxënësit e shkollave, duke i përfshirë këtu edhe studentet, por ne ç'do herë punojmë dhe veprojmë që ky bashkëpunim të rritet edhe më tej në një shkallë më të lartë", ka thënë Kelani. Ai vlerëson se edhe prindërit kanë një rol të rëndësishëm në luftimin e kësaj dukurie negative.

"Qytetaret, e në veçanti prindërit kanë një rol të rëndësishëm në luftimin e kësaj dukurie negative dhe këtë më se miri mund ta arrijnë duke bashkëpunuar edhe me ngushtë me policinë e Kosovës dhe institucionet relevante", ka pohuar ai.

Kelani ka shpjeguar se policia e Kosovës ka bashkëpunim të mirë me gjithë qytetarët, ngase siç thotë ai, Policia e Kosovës është institucioni më i besueshëm dhe bënë përpjekje që bashkëpunimi qytetarë-polici të vazhdoj me ritmin e ngritjes edhe në nivel më të lartë. Por, krahas bashkëpunimit polici-qytetar-student, Kelani bënë të ditur se Policia e Kosovës bashkëpunon edhe me Organizatat Qeveritare, me qëllim të parandalimit të aktiviteteve ilegale, pra edhe të trafikimit e përdorimit të drogës.

"Ka organizata te tilla ku Policia e Kosovës bashkëpunon dhe mban takime te shpeshta me OJQ, agjensione dhe institucione tjera relevante me qëllim parandalimin, hetimin, zbulim-

in, trajtimin dhe arrestimin e personave që merren me aktivitete ilegale në fushën e drogave", ka shpjeguar zëdhënësi i policisë.

## **Policia e përkushtuar në luftimin e dukurive negative**

"Nën udhëheqjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme, si bartëse e strategjisë kundër drogave dhe në bashkëpunim edhe me Ministrinë dhe institucionet tjera është hartuar strategjia kombëtare kundër drogës, ku Policia e Kosovës ka dhënë kontribut të madh në identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e kësaj dukurie negative për shoqërinë tonë dhe shtetin në përgjithësi", ka bërë të ditur zëdhënësi Kelani, duke folur për angazhimin e policisë në luftimin e kësaj dukurie. Ai ka shpjeguar se kjo strategji është miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe hap pas hapi është duke u implementuar. "Çdo vit Policia e Kosovës zhvillon përafërsisht mbi 150 operacione në tërë Kosovën me qëllim ndjekje penale të personave

të dyshuar që veprojnë në forma individuale dhe grupore në përdorimin, kultivimin dhe trafikimin e drogës brenda dhe jashtë Kosovës", ka thënë Kelani.

Sipas tij, policia mbetet e përkushtuar në luftimin e kësaj dukurie duke hartuar strategji dhe plane të ndryshme, si në nivelin qendror, rajonal, ashtu edhe në atë lokal. Statistikat e policisë tregojnë se nga muaji janar deri në muajin qershor të këtij viti janë sekuestruar 20 kilogram heroinë, 56 kilogram marihuanë, 700 bimë kanabis, ku krahasuar me vitin 2009 rezulton që sasia e lëndëve narkotike të sekuestruara të jetë dukshëm më e madhe. Policia thotë se përkritazi me transportimin e lëndëve narkotike gjatë këtij viti ka pasur 250 të dyshuar, ndërsa ka zhvilluar 60 operacione, ku 51 raste kanë pasur të bëjnë me trafikim, ndërsa 83 raste kanë qenë të lidhura me posedim të lëndëve narkotike, kurse vetëm nëntë raste kanë pasur të bëjnë me kultivim të lëndëve narkotike.





UNIVERSITETI PËR BIZNES  
DHE TEKNOLOGJI




UNIVERSITY FOR BUSINESS  
AND TECHNOLOGY

INSTITUTI PËR STUDIME EKONOMIKE  
INSTITUTE FOR ECONOMIC STUDIES

# EKONOMIA ECONOMICS

REVISTË SHKENCORE - SCIENTIFIC JOURNAL



1

2010



UBT-ja mbajti videokonferencën e 6-të me radhë

# Kompetencat ndërkulturore

"Gjuha angleze na ofrohen mundësi të shumta për të përmirësuar jetën tonë. Mësimi i gjuhës në fjalë është një shans për Kosovën sepse e lidh me botën globale dhe jep mundësinë për të zgjeruar interesat personale dhe me kultura të ndryshme. Sot janë më shumë se një miliard njerëz që flasin këtë gjuhë, ku mundësia e vetme për të bashkëpunuar dhe për mbajtur kontakt në mes njerëzve është gjuha angleze", thanë Edina Nurkollari dhe Diellza Hasani, studente të UBT-së, gjatë prezantimit të tyre në videokonferencë para studentëve japonez



Prishtinë, 28 maj: Në vazhdim të ngjarjeve dhe konferencave me karakter ndërkombëtar, të organizuara në vazhdimësi nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Prishtinë, ky universitet sot ka organizuar për herë të gjashtë Videokonferencën ndërkombëtare me temën "Kompetencat ndërkulturore".

Konferenca është organizuar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Prishtinë në bashkëpunim me Universitetin Bunkyo-Tokio, Japoni.

Organizatorët e Videokonferencës ishin Prof. Yuko Ikuta, në Fakultetin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Bunkyo University dhe prof. Fatbardha Osmani në UBT dhe bashkëpunëtorë dhe pjesë e hulumtimit të cekur më lartë, dhe studente e dy Universiteteve në fjalë.

Në kuadër të konferencës

Kompetencat ndërkulturore në dy prezantimet e para u fokusuan mbi temën "Kosova shteti më i ri në botë" dhe tema e radhës "Pse e mësojmë gjuhën angleze".

Studentët e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), dhanë shumë informacione rreth historikut të vendit, për shtrirjen gjeografike, gjithashtu u fol edhe rreth fushës së turizmit, ekonomisë, ushqimit, mënyra e qeverisjes, traditat dhe zakonet, pavarësia dhe njohja e Kosovës nga shtete e botës si dhe integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian (BE)

"Kosova është pa dalje në det dhe ka një sipërfaqe prej 10.877 km<sup>2</sup> në qendër të Gadishullit Ballkanik, kufizohet nga Maqedonia, Shqipëria, Serbi dhe Mal i Zi. Ka tre lumenj që rrjedhin në detin Adriatik, Egje dhe Detit të Zi. Kosova sot ka 30 komuna. Një hulumtim tregoi se në 1991 popullsia e përgjithshme ishte

mbi 2.000.000 banorë, por në mes të 1991 dhe 1993 rreth 400.000 të rinj shqiptarë të Kosovës u zhvendos në vendet perëndimore evropiane për t'i shpëtuar shërbimit ushtarak të ushtrisë jugosllave. Më 1998, 100.000 shqiptarë u nisën në vend të huaja për shkak të shtypjes serbe", tha Lirigzona Morina bashkë me kolegët si Merita Jashari, Blerina Hoti, dhe Shpend Caka, gjatë prezantimit të tyre në videokonferencë para studentëve japonez, duke shtuar se standardet arsimore në Kosovë janë jashtëzakonisht të ulta në krahasim me pjesën tjetër të Evropës dhe, si ekonomia, që kanë vazhduar të bien për dhjetë vitet e fundit.

Kurse për prezantimin e dytë, për rëndësinë e gjuhës angleze në Kosovë, sa investojë prindërit për fëmijët e tyre në si dhe përqindjen e njerëzve sa flasin këtë gjuhë në vendin tonë.

"Duke mësuar të flasin

gjuhën angleze na ofron mundësi për të përmirësuar jetën tonë. Mësimi i anglishtes është gjithashtu një shans për Kosovën sepse e lidh me botën globale, jep mundësinë për të zgjeruar interesat personale në kultura të ndryshme. Sot, janë më shumë se një miliard njerëz që flasin anglisht, ku mundësia e vetme për të bashkëpunuar dhe për të pasur kontakt në mes njerëzve është gjuha angleze", tha Edina Nurkollari dhe Diellza Hasani, dhe shtuan se në gjuha angleze në arsimin e Kosovës fillon të mësohet që nga klasa e tretë e shkollës fillore dhe organizohen kurse të shumta për mësimin e gjuhës në fjalë.

Si pjesë shtesë e konferencës ka qenë performanca e studentes, Lirigzona Morina, e cila këndoi për studentët e Japonisë, dy këngë të vjetra shqipe ku impresionoi studentët japonez dhe ata të UBT-së. Kjo është konferenca e

gjashtë dhe studentët po arrin të informohen dhe t'i rrisin njohuritë e tyre në dy aspekte si për gjuhën ashtu edhe marrjen e informatave për shtetin dhe kulturën e dy vendeve.

"Vlen të veçohet se përgatitja e studentëve tanë ka qenë në mënyrë të kënaqshme si në prezantimin dhe shtjellimin e hulumtimeve të tyre po ashtu edhe të shprehurit në gjuhën angleze", tha prof. Qehaja-Osmani.

Po ashtu në fund të konferencës u fol se palët nga Japonia si studentët dhe profesorët që janë pjesë e hulumtimit, do vijnë në Kosovë për vazhdimin e punimeve dhe u vendos se në fund të muajit gusht po të këtij viti konferenca do mbahet në UBT.

Videokonferenca me karakter ndërkombëtar dhe shkencorë për herë të parë në vend dhe në rajon ka organizuar i vetmi Universitet privat në Kosovë UBT.



# Trajnime dhe certifikime profesionale



Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

## Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informative
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathësi negociimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

## Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

## Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

## Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

## Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

## Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktëve
- Aqum Komunitare e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatie
- State Protocol

## Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

## Teknologji Informative

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

## Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

**Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.**



# UNIVERSITETI PËR BIZNES DHE TEKNOLOGJI, ME RISI PROGRAMORE DHE CILËSI TË AVANCUAR TË STUDIMEVE

## PROF. DR MUSA LIMANI

S'ka dyshim se arsimiti paraqet bazamentin kryesor, ku shkollohen dhe ngritën kuadro të të gjitha profileve, dhe si i tillë ka karakter interdisiplinar dhe multidisiplinar. Pas luftës (1999) në Kosovë erdhi deri te ndryshimet politike dhe ekonomiko-shoqërore, ku me ç'rast filloi një etapë e re në të gjitha fushat jetësore, andaj edhe në arsimin e lartë dhe superior. Erdhi deri te ndryshimi i Ligjit për arsimin e lartë dhe superior, ku ndër të tjera u mundësua edhe hapja e Universiteteve private, që ka për me qëllim përfshirjen sa më të madhe të të rinjve në shkollimin superiorë. Me këtë rast, si në Universitetin Publik, ashtu dhe në Universitetet private u bënë ndryshime rrënjësore në planet dhe programet mësimore, të mbështetura kryesisht në Deklaratën e Bolonjës, që mundëson integrimin dhe transferin e studentëve të Universiteteve tona me ato evropiane e më gjerë. Madje, vlerësimi sipas kredive (ECTS), bënë të mundur që studentët tanë mund të transferohen në Universitetet Evropiane e më gjerë, qoftë për studime bachelor (studime të rregullta) apo master e të disertacionit të doktoratës, pa ndonjë problem të veçantë. Po ashtu, e gjithë kjo bënë të mundur, që studentët pas kryerjes së Fakultetit përkatës të jenë konkurrent të barabartë edhe në tregun evropian të punës.

Në kuadër të sistemit Universitar të Kosovës, është themeluar dhe vepron edhe Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT). Planet dhe programet, forma dhe regjimi i studimeve, në të gjitha Fakultetet dhe Departamentet e UBT-së, janë të hartuara dhe zbatohen sipas Deklaratës së Bolonjës. Siç dihet edhe në këtë vit UBT-ja ka aplikuar për akreditim për shumë programe. Në bazë të Raporteve pozitive të vlerësimit të ekspertëve ndërkombëtar dhe Këshillit nacional të Cilësisë, UBT-ja është akredituar përsëri si institucion i arsimit të lartë privat, në nivel bachelor dhe master fakultetet, të cilat janë të përshkruara në faqen 32, të kësaj gazete. Duke pasur parasysh planet dhe programet, si dhe rezultatet e arritura të deri tani për disa fakultete ekzistuese dhe



disa të reja për të cilat kemi aplikuar për herë të parë, e që nuk janë propozuar në pjesën e parë, shpresojmë se edhe këto fakultete deri në mbledhjen e radhës të Këshillit Nacional të Cilësisë, që do të mbahet në muajin shtator do të akreditohen. Ekspertët ndërkombëtar, për planet dhe programet, strukturën dhe thirrjet shkencore dhe akademike të stafit akademik, si dhe cilësinë e studimeve, për UBT-në kanë dhënë vlerësimet më të larta,

duke sugjeruar disa përmirësime të vogla të cilat do të evitohen, e që kanë të bëjnë me avancimin dhe ngritjen e cilësisë të procesit mësimor në tërësi. Duke u bazuar në strukturën e planeve dhe përmbajtjen e programeve të të gjitha Fakulteteve dhe stafit akademik, UBT-ja përgatit kuadro të profileve përkatëse që do të jenë në rend të parë në funksion të zhvillimit ekonomik-shoqëror të Kosovës dhe më gjerë. Niveli i

lartë i proceseve tekniko-teknologjike të prodhimit në vetë kërkon edhe profil adekuat kuadrosh, që mund të sigurohen vetëm nëpërmjet arsimit superior. Një numër i konsiderueshëm i këtyre kuadrove do të aftësohet pikërisht në UBT në Fakultetet dhe Departamentet përkatëse, që do të jenë bartës të transformimeve ekonomiko-shoqërore të Kosovës në periudhën e ardhshme. Siç dihet, revolucioni tekniko-teknologjik, ino-

vacionet teknologjike dhe proceset bashkëkohore prodhuese kërkojnë edhe kuadrin adekuat profesional i cili di t'i drejtojë ato, të cilat kuadro pikërisht do të aftësohen (përgatiten) në UBT, përkatësisht në Fakultetet dhe Departamentet përkatëse. Profili i kuadrove që përgatitet në UBT, është në hap me kohën dhe të cilat janë në gjendje të zbatojnë risitë dhe të arritura më të reja shkencore dhe t'i perfeksionojnë ato në jetën praktike. Kështu,



UBT-ja paraqet një institucion të arsimit superior privat, si input ku përgatit faktorin më të rëndësishëm të prodhimit, pra profile të caktuara kuadrosh profesionale dhe shkencore, i cili potencial do të ndikojnë në ndryshimet ekonomiko-shoqërore në Kosovë në periudhën e ardhshme. UBT-ja përgatit kuadro profesionale që din të udhëheqin bizneset dhe ekonominë e Kosovës sipas postulateve të ekonomisë së tregut. Andaj, situata në të cilën gjendemi sot dhe ndryshimet që priten të bëhen në të ardhmen nga aspekti ekonomiko-shoqërore, UBT-ja me planet dhe programet e veta të akredituara në këtë vit, si dhe strukturën e stafit akademik do t'i përgjigjet përgatitjes së kuadrove të profileve të caktuara sipas nevojave dhe ndryshimeve ekonomiko-shoqërore, si dhe do të bëjë përpjekje këmbëngulëse për integrimin e universitetit tonë në familjen e universiteteve të përparuar evropiane e botërore.

Përvoja e deri tanishme e funksionimit dhe studentët e diplomuar në UBT, më së miri flasin se ky institucionin superior arsimor privat ofron dituri, profesionalizëm, shkencë, sukses dhe perspektivë. UBT-ja ofron kushte më të mira në procesin mësimor: salla, laboratorime me pajisje moderne, grupe të vogla në ligjërata dhe ushtrime, punë praktike dhe staf akademik vendor e të jashtëm, me grada të larta shkencore, përvijë dhe prestigj të lartë të pedagogut.

Risi për këtë vit akademik, pos planeve dhe programeve të reja, UBT-ja sjell dhe fillimin e ndërtimit të kampusit në një hapësirë prej 3 ha. sipërfaqe e që do të ndërtohet me standarde evropiane dhe do të paraqes kompleksin universitar më modern në Kosovë. Në këtë hapësirë do të vendoset objekti për procesin mësimor me salla e amfiteatro më moderne, laboratorime e kabinete me pajisje bashkëkohore, konviktin për student, dhoma fjetje për profesorët që vinë nga jashtë, mini punëtori ku studentët do të kryejnë punën praktike, fusha sportive e kështu me radhë. Me këtë rast, UBT-ja do të krijojë kushte bashkëkohore dhe më të mira, si nga aspekti i interiorit ashtu dhe eksterierit si për student ashtu dhe personelin akademik dhe administrativ të këtij universiteti, se cilido universitet tjetër në Kosovë. Urdhëroni, ejani në UBT dhe do të bindeni për të gjitha këto. Nëse përcaktoheni të studioni në UBT, keni bërë zgjidhjen më të mirë, sepse ne jemi institucioni i arsimit superior më prestigjioz në Kosovë. Ne ju mirëpresim.

# Rrahmani, futbolliste dhe studente e suksesshme

Albina Rrahmani është njëra prej futbollisteve më të mira në Kosovë. Krahas futbollit, ajo është edhe studente e suksesshme në drejtimin për Management, Business and Economi, në Universitetin për Biznes dhe Teknologji. Ajo ka treguar për eksperiencat e saj me futbollin jashtë Kosovës, ndërsa e ka zbuluar ëndrrën e saj: të luajë për përfaqësuesen e Kosovës.

**QËNDRESA SYLEJMANI,**  
STUDENTE NË UBT

Albina Rrahmani është njëra prej futbollisteve më të mira në Kosovë. Ajo ka nisur të merret me këtë sport që kur ishte 13 vjeç. Është lojtare aktive dhe luan me ekipin "Kosova" nga Prishtina që nëntë vite me radhë. Ajo është lidhur ngushtë me futbollin, kështu që e ka vështirë që të largohet nga ky sport.

Rrahmani ka marrë shumë çmime dhe mirënjohje. Ajo është zgjedhur lojtarja më e mirë e vitit 2009 në Kosovë, çmim ky i ndarë për herë të parë nga Federata e Futbollit të Kosovës. "Kam arritur në një nivel ndoshta edhe profesionist, prandaj edhe është shumë e vështirë për mua të largohem nga futbollin, edhe pse jam në përfundim të studimeve në Fakultetin për Management, Economi and Business", tha ajo për revistën UBT.

Kur jemi te shkolla, Albina, katër vjetët e Shkollës Fillore i ka kryer në shkollën "Dituria", në fshatin Orloviq, ku edhe jeton sot. Pastaj, nga klasa e pestë deri në atë të nëntë, ajo është shkolluar në Shkollën Fillore "Naim Frashëri" në Prishtinë, drejtimi matematikë dhe informatikë. Pas përfundimit të gjimnazit, ka filluar studimet në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT). Pra, krahas futbollit, ajo përkujdeset edhe për shkollimin. Rrahmani thotë se i ka ndërlidhur mjaft mirë këto dy fusha, pasi shihet se arrin suksese në të dyja. Derisa të mundet, ajo nuk e ka ndërmend të heq dorë as nga futbollin e as nga studimet.

Dihet se Superliga e femrave në Kosovë ka filluar po verën që po e lëmë. Deri tash, Albina dhe shoqet e saj kanë luajtur vetëm ndeshje miqësore me ekipet jashtë Kosovës. Ajo tregon se ka qenë dy herë në Suedi me ekipin "Kosova", me të cilin ka arritur suksese të padiskutueshme. "Nga tri ndeshje me ekipe të cilat kanë përvijë 30-40 vjeçare, e që ne për to jemi si foshnje të porsalindura, një lojë e kemi fituar, një kemi mbetur baras dhe një tjetër e kemi humbur", nënvizon ajo.

Në fillim të këtij viti, Rrahmani ka qëndruar për tri javë në



Austri, përkatësisht tek klubi Linz, ku ka luajtur në 3 turne, duke kontribuar mjaft për këtë skuadër në dy prej këtyre turneve. Ajo ka shënuar plot 11 gola në 5 ndeshje. "Kisha disa përvoja të jashtëzakonshme, ngase këtu në Kosovë nuk kemi shumë mundësi për të treguar diçka, posaçërisht nëse luan futboll dhe merresh me ndonjë punë tjetër. Dy muaj më parë isha në Gjermani (Stuttgart), ku

e fituam vendin e parë, në një turne ku morën pjesë 24 ekipe të njohura gjermane. Shënuam 29 gola dhe nuk pranua asnjë. Edhe kjo ishte një eksperiencë e shkëlqyeshme", vazhdoi Rrahmani. Ajo njofton se është në kontakt me një ekip nga Gjermania, që t'i bashkohet për sezonin e ardhshëm, por për momentin nuk ka asgjë konkrete. Gjithashtu, Albina shpreson që

sa më shpejt të formohet Përfaqësuesja e Kosovës, derisa mendon se e meriton të jetë pjesë e saj. "Është nder për mua, si për çdo lojtar tjetër të jetë pjesë e përfaqësueses, pasi e përfaqëson shtetin e saj/tij. Gjithmonë kur luaj jashtë Kosovës, krenohem dhe e tregoj atë që jam dhe luaj për të, ngase sot më shumë se kurrë Kosova ka nevojë për ne", shtoi ajo.



Në UBT u prezantuan dy hulumtime si Shitësitë ambulante dhe Tregtia ndërkombëtare e mishit në Kosovë

# Mish, pemë dhe perime me bollëk



**Prishtinë, 15 qershor:** Studentët e vitit të tretë të Departamentit Management, Business and Economics në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), sot prezantuan seminarin e tyre të përgatitur në lëndën Project/Seminar, të prof. Schari Zafapour. Gjatë prezantimit të hulumtimeve morën pjesë edhe Edmond Hajriz presidenti i UBT-së, Burim Piraj, pronar kompanisë private "Meka", dhe studentët e departamentit në fjalë.

**SHITËSIT AMBULANT BËJNË MINIBIZNES NË KOSOVË**  
Tema e seminarit ishte "Shitësit

ambulant në Kosovë". Gjatë këtij hulumtimi studentët kishin bërë analiza të hollësishme dhe të ndryshme rreth shitësve ambulant, "fiks" dhe konsumatorit. Ata krahasuan këto dy mënyra të shiturit, apo të bërit biznes, dhe cekën se shitësit ambulantiv punojnë ilegalisht dhe është biznes i vogël në Kosovë duket krahasuar me shitësit "fiks", dhe shesin të gjitha produktet e njëjta, dmth produktet që i prodhojnë vetë si pemë, perime dhe lule të ndryshme etj. Pikat e shitjes për produkte e tyre janë rrugicat dhe kjo është një mangësi që nuk kanë një

infrastrukturë. Shitjen e produkteve më shumë e bëjnë gjatë sezonit të verës për shkak se njerëzit qarkullojnë më shumë. Kurse përparësi a tyre është që ata vetë i kultivojnë ato produkte dhe i shesin më lirë se shitësit "fiks". Gjithashtu koha ju jep mundësi që shitësit ambulantë të punojnë më gjatë, u tha gjatë prezantimit të hulumtimit Shitësit ambulant. Konsumatori - është i ndryshëm, ka prej tyre që nuk e preferojnë shitësin ambulantiv por ka prej tyre që janë të obliguar të blejnë nga ta, sepse jetojnë në zona rurale dhe nuk

kanë lokale afër tyre. Konsumatori shpesh nuk ndihen të sigurt që të blejnë produkte e gjera të tjera në rrugë sepse produktit i mungon e paketimi efikas, kontrollimi, kualiteti i dobët, d.m.th që ato produkte nuk janë gjithmonë të freskëta. Kurse të shitësit "Fiks" është pak më ndryshe, biznesi i tyre tërë kohën është i sigurt, nuk luan rol qarkullimi apo koha dhe tërë kohën mund të shesin produkte të llojllojshme, si p.sh të "Viva", "Etc", "Era". Studentët që bënë hulumtimin në fjalë janë si: Adem Hamza, Alban Bunjaku, Alban Bujupi, Albina Rrahmani, Erza Dina, Elza Zhaveli, Diellza Ademi, Mimoza Haliti, Shpresa Zeka, Shkurte Sahiti, Qendresa Sylejmani.

## PESË PËRPUNUES TË MISHIT

Hulumtimi "Tregtia ndërkombëtare më mish në Kosovë", zgjoi interesim të madh të pronarëve të kompanisë së mishit "Meka", po ashtu edhe të studentëve në përgjithësi. Aktualisht janë pesë përpunues të mishit në Kosovë si kompania "LGB", "Ben-af", "Meka", "Mish Kosova", "Koral", u tha gjatë prezantimit të hulumtimit Tregtia ndërkombëtare më mish në Kosovë. "Projektin e kemi filluar duke analizuar kompanitë e mishit "Meka"

dhe duke prezantuar profilin e kësaj kompanie, marrëdhënie tregtare me vendet e importuara dhe vështirësitë e tyre për rritjen e eksportit", tha prezantuesja e seminarit Ylberina Gashi.

Raporti i këtij seminar paraqet gjithashtu edhe hulumtimet që janë bërë në 10 vendet më të zhvilluara në lidhje me tregtinë e mishit. Po ashtu paraqet një pasqyrë të prodhimit, të importit, të eksportit etj. Vendet e zgjedhura të hulumtimit janë: SHBA, Hollandë, Gjermani, Brazil, Francë, Australi, Kanada, Zeland Re, Irlanda, dhe Argjentina. Të gjitha këto vende u shpjeguan thellësisht për prodhimin e mishit, konsumimin dhe lidhjet tregtare me vendet e tjera. Ky punim jep të dhëna përshkruese në ndërvprime të mishit në Kosovë me pjesën tjetër të botës. seminarin Tregtia ndërkombëtare më mish në Kosovë, e punuan studentët si: Ylberina Gashi, Donika Bucaliu, Vlera Halili, Granit Sahiti, Berat Thaqi, Fjolla Uka, Rina Dizdari, Islam Gjokokaj, Besiana Behluli, Arber Zeka, Shkumbin Radogoshi. Mësimdhënësi i lëndës së cekur më lartë, z. Zafapour, u nda i kënaqur me hulumtimet e studentëve dhe uroi punën dhe prezantimin e tyre të palodhshëm.

# Studenti i UBT-së formon grupin "Aragona Band"



**ARBËNORA GASHI**  
STUDENTE I VITI I-RË, NË UBT

Në absulventiadën e UBT-së, të mbajtur verës në "Hotel Brillant", në afërsi të kryeqytetit, ishte një organizim tejet i mirë, pritje komode. Nuk ka munguar as eleganca e studentëve, por ajo që ishte për t'u hamendur, ishte muzika të cilën e bënte grupi "Aragona Band". Njëri ndër anëtarët e grupit, Urim Abdullahu, kitarist

dhe student i UBT-së në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, ka thënë se: "Muzika e mirë bëhet kur ke publik të mirë, kështu siç është në këtë rast me absulventiadën e UBT-së, ku studentët janë shumë të gjallë. Këta studentë po japin energji dhe dëshirë për ta dhënë maksimumin. Madje, kur ke një ndjenjë të veçantë, sepse me këta njerëz kam kontakte të përditshme në forma të ndryshme, sidomos

në ligjërata, ku nuk mungon as suksesi i stafit të UBT-së, i: profesorëve, asistentëve dhe i presidentit të UBT-së, z. Hajrizi". Instrumentet të cilët i luan më së miri dhe i ka për dëshirë janë kitara klasike dhe flamengo. Grupi "Aragona Band" bën muzikë latine, po ashtu edhe etno dhe oriental, por nuk e harron as muzikën qytetare. Këtë e gjejmë mjaft aktiv duke

bërë muzikë në vendet më të pëlqyera tek publiku si në klube ku frekuentohen nga të rinjtë, ceremoni të ndryshme, fejesa dhe çdo manifestim tjetër në Kosovë. Ky grup është prezent edhe jashtë vendit si: në Shqipëri, Maqedoni dhe nëpër Evropë. "Në çdo vend kemi kaluar shumë mirë dhe njerëzit janë ndarë të kënaqur me ne. Niveli i kënaqshmërisë të njerëzit për muzikën që e kultivojmë ne

është për t'u dëshiruar nga çdo moshë", përfundoi Urim Abdullahu. Grupin në fjalë e përbëjnë pesë anëtarë: Urim Abudullahu (kitarist), Drin Haxhijakupi (vokal-violinë), Zgjim Bakalli (percussione), Shpend Haxhijakupi (daulle), Gramoz Krasniqi (sintisaizer). Grupi në fjalë është formuar në vitin 2006 me iniciativën dhe idenë e kitaristit Urim Abdullahut.

## Studenti i UBT-së kompozon "hitin" e verës "Lej fllëshat"

**VALËZA GELA**  
STUDENTE E VITI I-RË, NË UBT

Arijan Haxhixhemajli vetëm 20 vjeçar, me kompozimet e tij të këngës "Lej fllëshat", të rap këngëtarit Mc kresha ka bërë boom në mediet vendore. Arijanin e gjejmë edhe në UBT, i cili studion në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, por një pjesë të kohës e kalon në studion e vet duke komponuar këngë të zhanreve të ndryshme si Hip hop, RMB etj, dhe një prej këngëve që ka kompozuar po të zhanrit në

fjalë dhe që ka lansuar kohëve të fundit është kënga "Lej fllëshat" të rap këngëtarit Mc kresha dhe njëra ndër këngët më të dëgjura tek të rinjtë kosovarë. Arijani si kompozitor ka filluar të merret prej moshës 14 vjeçare dhe është duke punuar me të madhe në këtë drejtim më shumë se çdo gjë tjetër "Kur bëjë ndonjë kompozim të ndonjë kënge ndihem tepër mirë sepse punoj në profesionin tim", tha Arijani, duke pohuar se të ardhmen e vetë e sheh me dy profesione si kompozitor dhe si biznesmen.





# Iku pa u përmendur

**ILIR MUHARREMI**

Duhet të flasësh kur nuk heshtë dot më, dhe të flasësh vetëm për atë që është e kapërcyer, sepse të tjerat që mbesin janë, fjalë, mungesë disipline, kulturë etj. Heshtja shpesh herë shpërthen nga ngacmimi ekstrem i së keqes, por edhe e keqja është pjesë në të mirën, të dyja të bashkuara janë krijuese. I ndjeri Bekim Fehmiu, në testamentin e tij të shënuar, botën e shndërrimit të vlerave e quan lavire të baltosur nga e cila nuk kërkon fare hise, por thjeshtë është si një mysafirë i pa dëshirë i vendosur nga dikush tjetër, por rrugën e ka gjetur vetë nga një konkurrencë milionëshe spermatozoide. Po kthehemi në kohë, tek rruga para krimbit. Nga erdh Fehmiu?! Kush është?! Dhe ka shkoi?! Përgjigja e këtyre pyetjeve, është e mbështjell sikur gratë egjiptiane, dhe na kthen në një filozofi supozimesh me fare pak të vërteta, ose tek skeptikët. Fehmiu e gjeti rrugën, arriti ti mund konkurrentët me miliona, dhe erdhi në këtë botë siç e quajti në fund lavire. U ushqye nga ajo, krijoi pasqyre në vetën e tij, arriti ta lexoj talentin e tij, u bë i sinqertë me vetën, madje edhe e tejkaloi vetën dhe shkoi në një lartësi ku zogjtë e rrallë fluturojnë sepse gjërat mëdha janë për njerëzit e mëdha, dekadencia është farefis i ngushtë me dekadentët. Edhe në këtë botë, arriti ta mposhtë konkurrencën, i mbeti besnikë karakterit të stërvitur të paralindjes dhe si duket tek ky artist kujtimi i paralindjes nuk ka vdekur, por vetëm është zhvilluar në shkallë edhe më të lartë. Pak njerëz e njihnin pasqyrën e tij të vërtetë, ose e njihnin shumë mirë dhe frikoheshin nga beteja e ashpër



e këtij Napoleoni artistik, se mos vallë po pushton ashpër botën e tyre dhe po bëhet perandor i pathyeshëm. Fakt, u bë i thyeshëm, dhe humbi në harresë dhe unë si studentë i aktrimit dikur, asnjëherë nuk kam dëgjuar ndonjë fjalë për këtë legjendë të bërë pas vdekjes, ose të paktën të përmendëj ndonjë rol i tij, jo kjo nuk ndod-

hi në të gjallë, por pas vdekjes u ngritë si piktori Holandez Vinsent Van Gogh. "Kafeneja e natës" e Goghut po shndërrohet me legjendën e "Mbledhësit e puplave", ato pupla të legjendës fjetën, derisa ai vet njoftojë përjetësinë dhe u lirua nga kopeja. Nuk e di përse, i ndjeri nuk përmendëj, dhe nuk dërgoji mësim nga

largësia, ta ushqej këtë kope të uritur, e cila tashmë përmend momentet e tij dhe secili prej kopesë paraqet momentet intime të legjendës. A mos vallë është dashur që edhe ai ta pret veshin si Goghu, dhe ta shprehë publikisht depresionin, jo jo ai përmbajti vetën dhe shkeli në gjakun deri në gjuhë, dhe ëndrra më nuk kishte. Çdo gjë

rreth tij fillojë të thahet, madje edhe shpirti i uritur për ajër. Fjala e fundit e lënë si testament nga vargjet e poetit Dushan Vasilejv nga legjenda Fehmiu ishte: "Vëllanë armik të mallkuar e kam quajtur dhe jam hedhur në errësirë përpara duke klithur, e atëherë edhe Zoti, edhe njeriu, edhe istikami fluturojnë në ferr".

## A mendoni se studimet në UBT ju kanë ngritë profesionalisht në nivelin që mund të jeni konkurrent me arkitektët jashtë vendit?

Të gjithë studentëve të ardhshëm në UBT ju uroj studime të mbara sikurse mua

**Iliriana BAJRAKTARI**

Sikurse koleget e mija si Leana Muahmuti dhe Arlinda Shaqiri, që sot po punojnë dhe po bëjnë studime posdiplomike nëpër vende të Evropës, dhe pasi UBT na ka dhënë këtë mundësi mendoj së shpejti edhe unë ta vazhdoj një rrugë të tillë. UBT ka qenë një pjesë shumë e rëndësishme e karrierës sime, shpresoj të jetë edhe në të ardhmen, një pasqyre dhe urëlidhëse për një vazhdim



të mëturshëm në profesionin tim, këtë nuk po e them vetëm për vete por edhe për kolegët e mi. Të gjithë studentëve të ardhshëm në UBT iu uroj studime të mbara sikurse mua.

**Anisa KRYEZIU**

Mendoj që UBT-së në mënyrë indirekte i takon merita, sepse ata të cilët na kanë sjellë deri në këtë nivel, kanë qenë profesorët internacional. Edukimin të cilin na kanë dhënë këta profesorë ka qenë i një përkushtimi të lartë, me profesionalizëm dhe gjithmonë korrekt. Përveç

edukimit dhe përvojës profesionale që e kanë ndarë me ne, në mënyrë natyrale ka rrjedhë edhe një lloj influencimi pozitiv i kulturës Evropiane në karakterin tonë si arkitektë të rinj. E si provë për nivelin e njëjtë me kolegët jashtë vendit, e dëshmoi së fundmi përkushtimi dhe suksesi i madh i treguar në workshopin e organizuar në bashkëpunim me studentët e Austrisë. Aty kemi pasur rastin të bëjmë vlerësimin e vlerave tona, njohurive dhe edukimit në krahasim me këta studentë.

**Labinot MEHMETI**

Studimet në UBT kanë qenë një baze e fortë për të arritur në këtë nivel profesional që kemi marr në fushën e arkitekturës, dhe padyshim ka qenë meritë e një kuadri të mirë ligjërimit në Fakultetin e Arkitekturës. Duke i parë përvojat e mëherëshme me kolegët e tanë nga jashtë si gjatë vizitës në Austri, dhe një workshop që kemi organizuar në UBT bashkërisht me studentët e Austrisë të Universitetit të Innsbruck mund të them që asnjëherë nuk jemi mbrapa tyre, duke mos vërejtur ndonjë ngecje.



# Shërueset e 11 Shtatorit



## "NEW YORK TIMES"

Gjatë kësaj fundjave, Susan Retik, një hebreje që humbi bashkëshortin gjatë sulmeve terroriste të 11 Shtatorit, planifikon të flasë në një xhami në Boston. Ajo synon të gjejë mbështetës në mesin e besimtarëve që frekuentojnë këtë xhami, për betejën e saj kundër varfërisë dhe analfabetizmit në Afganistan.

Susan Ritek ka ndjekur ndoshta rrugën më të pazakontë dhe njëherësh më frymëzuesen pas sulmeve të 11 Shtatorit. Ky përvjetor i sivjetshëm tingëllon vrazhdë, pasi disa po përpiqen ta kujtojnë me fjalë urrejtje dhe djegien e Kuranit.

Menjëherë pas sulmeve terroriste, Retik u lidh me një tjetër grua, PATTI Quigley. Të dyja kishin humbur bashkëshortët në ato sulme ndërkohë që prisnin të bëheshin nëna. Fëmijët e tyre nuk do t'i njohin baballarët. Të dërmuara nga tragjedia, ato kuptuan se të veja si ato ishin rreth gjysmë milionë gra në Afganistan. Ky numër do të rritej derisa atje nisi një tjetër luftë. Të dyja gratë kuptuan se të vejat afgane mund të ishin një forcë stabilizuese në vend. Në kohën kur qeveria

amerikane reagoi me raketa e bomba pas sulmeve të 11 Shtatorit, Retik dhe Quigley i drejtuan sytë nga projektet që luftojnë varfërinë, në vendin ku ishin ngjizur sulmet që i ndryshuan jetët e tyre.

Organizata që ato nisën "Beyond the 11th" deri tani ka ndihmuar mbi 1000 të veja afgane që të fillojnë biznese të vogla. Është kjo një përpjekje për të ndihmuar një nga grupet më në nevojë në botë, si dhe për t'iu përgjigjur ndryshe mosbesimit, urrejtjes dhe papunësisë të ngritur nga talibanët.

"Më shumë vende pune do të thotë më pak dhunë", thekson Retik dhe shton:

"Është naive të mendosh se ne do ta ndryshojmë atë vend, por ndryshimi duhet të nisë nga diku. Nëse mund të aftësojmë një grua që të jetë në gjendje të sigurojë jetesën për familjen e saj, kjo do të thotë se së paku katër ose pesë veta do të kenë një strehë mbi kokë, ushqim në tryezë dhe një mundësi për arsim".

Në kohëra të errëta kemi tendencën të shtypim pjesën tonë të mirë. Me këto dy zonja ka ndodhur ndryshe. Paul Barker, që ka punuar për shumë vjet në Afganistan me organizatën "CARE", thotë se nëse qeveria

amerikane do të ndante pasionin e këtyre grave për arsimin dhe zhvillimin, do të ishte arritur shumë më tepër.

Në mesin e aktiviteteve të iniciuara nga këto dy gra, janë ngritura e një fabrike për prodhimin e topave të futbollit, ku të punësuar, por dhe drejtimin e kanë marrë gra të veja, të cilat më parë janë aftësuar. Po kështu, një numër kryefamiljaresh janë pajisur me pula apo gjë të gjallë që të mund të sigurojnë jetesën për familjet e tyre. Projekti i ardhshëm i zonjës Retik në Afganistan është të mbështesë një projekt për mikrofinancat. Është e qartë se të gjitha këto aktivitete nuk do ta kthejnë Afganistanin në një vend paqësor. Por, faktet tregojnë se përmes arsimit e zhvillimit bëhet më shumë për të luftuar fundamentalizmin. E, këto rrugë janë edhe më të lira.

E admiroj punën e zonjës Retik se ajo është e kundërta e histerisë anti-islame që po errëson aktivitetet e këtij përvjetori të 11 Shtatorit.

Puna e saj synon t'i bashkojë të gjitha fetë kundër armiqve të përbashkët të njerëzimit, padijes dhe varfërisë, çfarë reflekton një fuqi morale e mendore, e aftë që të mund të largojë terrorizmin.





# Importance of education and career in Kosovo

## MIMOZA HALITI

GRADUATED IN MANAGEMENT BUSINESS AND ECONOMICS – UBT

Life is not just to live it; we should also make it valuable. In today's life the education became one of the most important things. Being part of affirmed world is not so easy. We all have some goals that we want to reach during our life and for this we should have a motivation to live and study or work to reach those particular goals. Today, especially in Kosovo, almost everybody decides to study and then have a successful career. There are many people that also in the past build a sensational career, but possibilities, circumstances and conditions were limited. Almost everyone dreams for his/her career that he/she will build in future.

Kosova now is a new state and it is passing through important processes to become a developed country. It is logical that my country needs people who can help it to go forward. Myself and everyone around want to contribute in Kosovo's progress, for this cause me and everyone who wants to be a successful leader for a successful country should have a good education in order to be abounded with knowledge and have an affordable



career. In the last 10 years in our new state were opened around 10 or more private high schools and universities such are: American School of Kosovo, Prishtina High School, University for Business and Technology, American University of Kosovo, Gjilani, Fama, Iliria, Universum,

Rezonanca, Victory and AAB. So, there are opened more possibilities and better conditions for us as new generations to study and then construct a career. Good education is result of good schools, universities and good teachers or professors. Top high schools and top universities such are American

School of Kosovo, University for Business and Technology and American University of Kosovo offer special studies in English and with international professors. This was something new in Kosovo and a good opportunity for new generations to study in the same way of how they could study abroad.

Not just education and trainings suffice to build a praise career. Working hard, volition, responsibility, inspiration, seriousness, different skills, effort, motivation, experiences and different successes are some basic features that career binds. Each of these features needs time and dedication to be part of our personality. Of course, it is not so easy to reach the peak of personal career. Along the road, that everyone passes making their career, encounter in many barriers. To be resolute, firm and also calm are some types of personalities and some of the main characteristic that people should have in order to pass different challenges or failures. In this way they may not incur disappointment.


Desire or willingness to build a career is very normal but possibilities are often scarce. As career builder, we should have in our mind some principles defined. To be sure that we will not lose our toil

that we do to build a career, we should think well for our preferred profession. We should decide what we want really to be in the future and then study for that field. If we do not think about these things in details and we just study for something that our parents or friends did, we will have a big problem in the future building our career. This happens because we can study for some years anything, but we cannot work for the rest of our life in the profession which we do not like cordially and honestly. So, working just for money and not why we really like doing that job, brings us many fiascos and disappointments.

Changing career pattern is a serious problem, which make us lose our self-confidence and volition for the next job.

"A career is the pursuit of a lifelong ambition or calling." This is a phrase that I read in one of the books I read before. Today's dynamic life pushes everyone to do and to think about career as something very important and certainly. It really is the career for what we strive through all our life. We all should exploit our capacities and become leaders in our new independent country. So, one of the most important advantages and flatters of life, except family, is a successful career.

## UBT ME KAMPUS TË RI UNIVERSITAR



Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), brenda vitit të akademik 2010/2011, procesin mësimor pret ta organizojë në kampusin e ri universitar. Kampusi i ri është në afërsi të QMI-së, në Komunën e Lipjanit.

Projekti i kampusit është projektuar nga studentët e diplomuar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT si Ardian Muhadri, Fidan Belegu etj, dhe stafi akademik ndërkombëtar e vendor.

## UBT organizon konference ndërkombëtare në nivel botëror



Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), këtë vit është organizator dhe mikpritës i konferencës ndërkombëtare "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability", e cila

do mbahet në muajin tetor 2010. Deri më sot ka pasur interesim të madh dhe pritet një pjesëmarrje masive e shkencëtarëve nga e gjithë bota. Organizatorë dhe sponsorë të Konferencës në fjalë janë Universiteti i Vjenës për

Teknologji, IHRT, Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe Federata Ndërkombëtare e Kontrollit Automatik (IFAC). Menaxhmenti i UBT-së është në përgatitje intensive që mysafirëve gjatë qëndrimit të ndihen sa më mirë dhe komod.

# Salus: Windows me licencë, Unix pa licencë

**Prishtinë, 29 shtator 2010-** Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) vazhdon traditën e organizimit të ligjëratave me personalitete nga jeta shkencore dhe e kulturës, si me përfaqësues të institucioneve vendore ashtu edhe me ato ndërkombëtare.

Ndaj në këtë vazhdë, Peter Salus, autor i disa librave mbi historinë e zhvillimit të shkencave kompjuterike dhe sistemeve operative, pjesëmarrës dhe dëshmitar okular i momenteve kyçe të zhvillimit të sistemeve operative Unix e Linux, sot, para studentëve, profesorëve e mysafirëve të UBT, mbajti një ligjëratë me temën "Historia e Sistemit Operativ -Unix".

Gjatë ligjëratës, z. Salus, përmendi zhvillimin e hovshëm të kompjuterëve ndërsa si kra-



hasim bëri periudhën e viteve 1960 dhe 2010, ku në vitet e 60 – ta, sipas tij, gjendeshin 16

kompjuter në gjithë botën ndërsa, sot, më 2010, llogariten të jenë gjithsej 1.8 mil-


iard shfrytëzues të kompjuterëve dhe natyrisht edhe te sistemeve operative.

z. Salus përmendi të gjitha zhvillimet e rëndësishme duke iu referuar datave ekzakte të ndodhjeve të tyre dhe gjithashtu edhe personave përgjegjës për krijimet e tyre. Ai bëri krahasime duke filluar nga madhësia e kompjuterëve të parë, çmimeve nëpër periudha të ndryshme kohore, se si bashkërisht ato shkonin duke u zvogëluar. Gjithashtu përmendi edhe rëndësinë e madhe që ka bërë zbulimi i internetit dhe zhvillimi i tij, por pa përfshirë edhe zhvillimet në siguri.

Piter Salus i bëri vërejtje të madhe sistemit operativ Windows, ngase për çdo program kërkon licencën të veçantë, "kurse sistemi operativ Unix dhe programet e këtij sistemi janë të ofruara pa licencë", tha ai.

# Qytetar nderi në SHBA dhe fitues i medaljes së artë

Studenti i UBT-së shpallet Qytetar nderi në SHBA dhe fiton medaljen të artë nga German Proficiency Badge



Jeton Ahmeti, i cili studimet themelore i ka përfunduar në Fakultetin Shkencë Kompjuterike në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), ku për mentor teme të diplomës caktohet te Prof. Dr. Peter Kopacek me temën "Movement Patterns of Bioid - Humanoid", paralelisht ndjek edhe studimet në Qendrën për Studime Universitare në (FSK- QSU), një kohë qëndron në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku merë disa certi-

fikata në drejtimet profesionale, disa medalje të arta dhe shpallet qytetar nderi. Në SHBA certifikohet në fushën e Sigurisë së Dhënave (Security + Professional), në Rrjeta Kompjuterike (CCNA) dhe shpallet Qytetar nderi i qytetit Huntsville Alabama, për arsye të arritjeve akademike dhe ushtarake gjatë trajnimit, gjithashtu fiton Medaljen e Artë në German Proficiency Patch GPB në garat të cilat organizohen nga Zyra

ndërlidhëse gjermane në Fort Gordon – Georgia (Baza ushtarake të cilën ka qëndruar). Pas trajnimit punësohet në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Departamentin e IT-së në Komandën e Forcave Tokësore në Prishtinë, dhe prapë, po në këtë vit akademik që jemi ka regjistruar dhe është ka vazhdon me sukses studimet posdipomike Mastër, në UBT, në Departamentin ICT (Information and

Communication Technology). "Të gjitha njohuritë e mia të cilat i kam fituar në Universitetin për Biznes dhe Teknologji UBT, në Forcën e Sigurisë së Kosovës FSK dhe në Amerikë do i aplikoj në vendin tim në FSK". thotë Jetoni për revistën "UBT Alumni" dhe për gazetën e studentëve të UBT "UBT News". Specializimet për Teknologji Informativ u janë ofruar nga FSK-ja.

Komenti i tij për UBT-në është " Më mungojnë shprehjet që të përshkruaj UBT-në, por të studiosh në UBT është privilegj dhe nder, nuk duhet lënë pa e shfrytëzuar. Gjithashtu Jetoni është pjesëmarrës i ekipit të futbollit të robotëve dhe në garat Europiane në Viene bashkë me kolegët e vetë kanë marrë vendi i IV-të, gjithashtu një vit më pas në organizimin e kampionatit europian në Prishtinë kanë fituar vendin e III-të.



Interview with vicepresident of UBT, Derek Shields.

# UBT WILL GROW



On my first, and subsequent visits to Kosova and UBT, two things impressed me. First, at the political and bureaucratic levels, the outstanding team that had been put together by your very able minister to guide the development of education in Kosova. Second, at the institutional level, the knowledge, understanding and realistic ambitions of the President of UBT. Vicepresident of UBT, Derek Shields, speaks for UBT News.

**NAILE DEMIRI**

**UBT News: Can you say something about yourself and your professional engagements?**

**Derek Shields:** Most of my professional life has been spent in education, teaching, research, and, in particular, assessment, quality and standards. In the last 10 years or so, much of my work has been

concerned with the accreditation of university degree programmes in the UK, China, USA, Canada and Africa. A little over two years ago, I was invited to Kosova, to report on the legal conformity, degree provision and quality in the private Higher Education (HE) sector.

**UBT News: Prof. Shields you are engaged in quite high position and responsibility? How comfortable you feel in UBT and its politics?**

**Derek Shields:** UBT and its politics interest me, mainly in relation to the politics of development in Kosova and the region. This is why I'm here. Do I feel comfortable? No, but I'm not looking for comfort, but potential. In the smaller politics, I believe there is potential in UBT to grow, whilst at the same time improving standards of provision and output. In the larger politics, I believe that Kosova has some very able, dedicated and approachable people leading developments.

**UBT News: Which section in UBT you will manage, and what you will change?**

**Derek Shields:** In UBT, I'll be responsible for all academic affairs – teaching, research and international partnerships.

Changes? Attitudes and engagement top the list.

Attitudes: our primary function is teaching; engagement: academic administration is not exciting but it's necessary and done well, will create time and space for the President to promote the value of UBT.

Any changes I've sought to introduce have been designed to improve the overall student experience; to improve output standards; and to raise the research profile of academics and the institution. Changes will be effected through dialogue with academics and administrators who relate most extensively and effectively with the students.

**UBT News: What did motivated you to come in Kosova, or better to say in UBT and to manage the sector mention above?**

**Derek Shields:** On my first, and subsequent visits to Kosova and UBT, two things impressed me. First, at the political and bureaucratic levels, the outstanding team that had been put together by your very able minister to guide the development of education in Kosova. Second, at the institutional level, the knowledge, understanding and realistic ambitions of the President of UBT.

**UBT News: You have a long experience in teaching and managing of education**

**institutions in your country and abroad. Can you make a comparison between private education there and here in Kosova, UBT?**

**Derek Shields:** In the UK, private schools have a long developmental history and a culture of excellence and achievement at the top strata. At the HE level, there is little private provision (although franchising is tending to blur the picture – as in Kosova, but that's another story), with many high-quality public (although non-government) universities leading the world rankings – for example: Cambridge, Oxford, University College, Imperial and LSE (all London) featuring in the top ten universities.

Kosova is institutionally young. Here, in the HE sector, there would seem to be a relatively weak public sector, consisting of one institution, numerically relatively large but resource weak (things and people); and a private sector consisting of several institutions, of various quality, each numerically relatively small, each with restricted resources (science and engineering are prohibitively expensive).

Comparisons are tricky. My interest is not so much in quantitative measures, but the quality of intention, delivery and output. (Incidentally, this sort

of distinction makes accreditation in the UK and the USA quite different from accreditation here, and in Europe generally, where it seems very programmatic, confrontational and evidence-weak.)

Whether public or private, one would expect institutional aims to be similar: quality of student experience measured against putative output standards; quality of programmes; quality of teaching and assessment (remember, that tells us about the student and the teacher); research; and effective interaction with the body-politic, the economy and society. If such qualitative aims can be achieved, then there should be little tension between UBT and government objectives.

**UBT News: There are some voices around that you made pretty big projects for further development of academic and administrative system in UBT, which are those projects and are appropriate? How much you have found support from the President of UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi to implement this project?**

**Derek Shields:** Any proposed changes are intended to enable UBT to achieve qualitative aims at the institutional level and to cohere with government developmental objec-

tives at the policy level. In private institutions, parents and students are investing heavily for future success, and it's the purpose of UBT to do everything possible to help them to achieve that hoped-for success.

How? First, by offering innovative programmes linked to future employability. Second, by providing top-quality teaching and research opportunities. Third, by providing meaningful and stretching assessments and so demonstrating to regulators and potential employers that we are generating top-quality graduates. Fourth, supporting students in their post-graduate careers. If there are any changes that will help UBT achieve those ends, perhaps we have a corporate duty to make them, and that as soon as possible?

As I said earlier, it was my judgement that the President of UBT understood what he was doing and expressed realistic and achievable ambitions for growth within a quality framework. So far, although there have been differences in proposed ways and means, in strategy and tactics, I have not detected lack of support in the pursuit of our shared aims.

#### UBT News: How do you see the future of UBT?

**Derek Shields:** The future of UBT depends on all involved recognizing the need to change and grow. The keys are attitude and engagement: if we can change staff attitudes to their responsibilities and accountabilities and strengthen staff engagement, then the future can be one of steady and sustainable growth, driven by good-quality student demand for places here. If not, the future seems to be one of steady decline, not necessarily in numbers, but in the prime imperative: quality.

#### UBT News: How ready you are for the beginning of new academic year 2010/2011?


**Derek Shields:** It's been a long summer and the place has seemed empty. I'm ready for the challenges that a full complement of students and staff will bring.

#### UBT News: Your message for new students of UBT?

**Derek Shields:** I learnt one thing at Cambridge: when at university, do what interests you until you are asked what you are up to.

Make sure you are clear about what you expect from UBT; that your expectations are realistic when set against the effort you are prepared to make; and make sure we offer you the guidance and support to realize those expectations.

# PRERJA E ARTË



#### PROF. MEHMET VOKSHI DIZAJNER I ENTERIERT

Nëse sipërfaqen e letrës e ndajmë në atë mënyrë që njëra anë t'i konkurrojnë dukshëm me madhësinë e saj tjetrës ose ana tjetër që është më e vogël ta potencojë mirë madhësinë e tjetrës, atëherë mund të themi se ndarja e sipërfaqes së letrës është bërë sipas "prerjes së artë". Nëse bazohemi në konkludimin se karakteristikë apo veçori (e përjetimit) të fenomenit estetik është qartësia dhe lehtësia e perceptimit ose e të vërejturit, atëherë del si përfundim logjik se fenomeni joestetik është paqartësia, jodefinimi nga e cila rezulton hamendja, dyshimi dhe josituria. Çka kuptojmë me këtë?

Syri i njeriut kërkon raporte të qarta që t'i pranojë pa vështirësi, gjegjësisht që i përgjigjen kërkesave vizuale të harmonizuara pa marrë parasysh a janë (vija apo sipërfaqe) të njëjta ose jo të njëjta. Me rastin e përsëritjes së madhësisë (dimensionit) së njëjtë, formës dhe drejtimit, themi se kemi të bëjmë me simetrinë e cila paraqet një raport të caktuar e të qartë e që vetvetiu nënkupton një përjetim estetik. Asimetria (raporti jo i njëjtë) nuk do të thotë mungesë e fenomenit estetik, sepse edhe

ky fenomen mund të përjetohet estetikisht, por me kusht që raportet në mes të pjesëve jo të barabarta të jenë të sakta e të qarta, e jo të na bëjnë të dyshojmë e të hamendemi. Shikuesit t'ia bëjmë të qartë cila pjesë ndaj të cilës dominon. Si raport më të bukur të dallimeve dimensionale (të madhësive) merret përpjesa e PRERJES SË ARTË. Ai raport në përpjesë është 1:1,618. Çka është prerja e artë? Prerja e artë (në latinisht *sectio aurea*) paraqet raportin në mes të dy pjesëve jo të barabarta të një drejtimi, te i cili pjesa më e vogël potencon (shpreh) pjesën më të madhe, sikurse pjesa më e madhe që është në raport me tërësinë e të dyja pjesëve të atij drejtimi. Emërtimin e këtij rregulli e ka dhënë piktori italian i Renesancës Leonardo Da Vinci i cili supozonte se "kjo ndarje jep përshtypjen e një harmonizimi e drejtëshimi linear në asimetri, drejtëshim ky me influencë në përjetim se sa në cilëndo prerje tjetër". Qysh në Greqinë e Vjetër ka qenë e njohur prerja e artë të cilën Euklidi e quajti "ndarja në raportin e skajshëm dhe të mesëm". Edhe pse arti në Kinë dhe Japoni u zhvillua pavarësisht nga ai i Evropës, prerjen e artë e gjejmë edhe në veprat artis-

tike të këtyre vendeve.

Me përcaktimin e raportit të prerjes së artë, meqenëse po themi se pjesa më e vogël raporton ndaj pjesës më të madhe, sikurse pjesa më e madhe ndaj tërësisë së të dyja pjesëve, e shfrytëzojmë këtë raport edhe në mes të numrave të cilin e quajmë "rendi i artë": 2, 3, 5, 8, 13, 21, 34, 55, 89, 144 etj. Secili numër i këtij rendi paraqet shumën e dy numrave paraprak. Në bazë të hulumtimeve është ardhur në përfundim se skulptura "dorifor" e skulptorit grek Poliklet e cila përmban kanunin e asaj kohe, paraqet figurën e njeriut e cila në të gjitha pjesët e saja i përshatet proporcioneve të prerjes së artë. Njeriu i zhvilluar mirë me proporcione të sakta të trupit është i formuar sipas "prerjes së artë". Prerja e artë mund të mësohet, njeriu kurrsesi nuk mund të ketë "ndjenjë" për të. Pllakat i mirë është ai që është i komponuar në sipërfaqen e letrës në bazë të prerjes së artë. Varësisht nga përvoja dhe imagjinata e artistit edhe pllakati mund të ketë vlerat e një pikturë. Me ngjyrat e zgjedhura, kompozicion të studiuar, me shkronja të qëlluara e në harmoni me përmbajtjen e tekstit dhe me dimensionet e

pllakatit në tërësi.

Komponimi sipas prerjes së artë të çfarëdo vizatimi ia shton vlerën, e bën atë më të këndshëm për shikim, më shpirtëror dhe njeriu ndien lehtësi kur atë e sodit me shikim dhe ia zhvillon imagjinatën, e inspiron për të krijuar vepra të tjera. Prerja e artë i bën veprat arkitektonike t'u ngjajnë skulpturave, sheshet skenografive. Njeriu në këso mjedise me forma tejet të racionalizuara ndryshon sjelljen e vet dhe fillon të jetë më racional në lëvizje, në harxhimin e energjisë etj. E gjithë kjo shkon në favor të humanizimit të jetesës së njeriut dhe masës së gjerë njerëzore. Prerja e artë në artin aplikativ ka rëndësi të posaçme sepse arti aplikativ është në funksion të humanizimit të jetës së njerëzve, të masës më të gjerë, duke iu dhënë gjërave, mjeteve për përdorim, forma tejet funksionale e me pamje sipas parimeve të artit dhe estetikës. Dizajnerët, arkitektët mbajnë përgjegjësinë për rregullimin e rrethit, mjedisit, të vendit tonë me projekte të kualitetit të lartë, cilësia e të cilëve do të shquhej për nga individualiteti dhe atraksioni me primesa të elementeve të trashëgimisë së kombit tonë që do të theksonte originalitetin dhe atdashedashurinë.





**TEB**

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

# BANKË PËR NJË BOTË NË LËVIZJE



# TVSH, tatim stimules apo destimules për investimet në Kosovë

**MR. SELMAN BERISHA**

Në përgjithësi tatimet shihen si burim kryesor i të hyrave të qeverisë. Qeveria ka për obligim të aplikojë politika fiskale të cilat do të jenë të pranueshme nga bizneset, qofshin ato korporata apo biznese individuale, me qëllim të nxitjes së investimeve në vend. Sa do të jetë ajo përqindje tatimore e pranueshme nga bizneset? Këtë më së miri e shpjegon burrështetasi francez Zhan Baptist Kolber (Jean Baptiste Colbert) i cili thotë: Arti i tatimit është arti i rrjepjes së një pate, për sa më shumë pupla të jetë e mundur të mbledhësh nga ajo, por me sa më pak klithma. Në Kosovë, këto klithma a dëgjohen, sa dëgjohen dhe sa janë të drejta?

Klithmat për TVSH-në kanë filluar qysh nga korriku i vitit 2001, atëherë kur filloi zbatimi i këtij tatimi në Kosovë. Sot e kësaj dite, asnjë biznes nuk pajtohet me mënyrën e zbatimit të TVSH-së, megjithatë kjo ende ka mbetur formë e zbatimit. Ky tatim për herë të parë është zbatuar në Francë në vitin 1954 kurse tani zbatohet edhe në 120 vende tjera të botës. Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) është tatim konsumi që e paguan konsumatori i fundit dhe është gjithëpërfshirës.

TVSH-ja në Kosovë zbatohet në kufi, për të gjitha hyrjet e mallrave, pos mallrave që janë të liruara nga TVSH-ja. Në shikim të parë, vjelja e TVSH-së në kufi do të thotë ngulfatje e ekonomisë, meqë inkason çështje që ende biznesi nuk e ka realizuar. Kjo do të thotë se për të gjitha stoqet që gjenden në magazinat e bizneseve TVSH-ja është paguar dhe në mënyrë direkte reflektohet në mungesën e mjeteve qarkuluese (parasë) në biznese dhe rrjedhimisht si rezultat i kësaj koeficienti i xhirimit është më i ulët. Bizneset kosovare në kontekst të kësaj kanë gjetur një rrugë tjetër të balancës tatimore, duke pranuar fatura nga furnitorët me çmime dukshëm më të ulëta, si dhe duke i trajtuar mallrat si gjysmëprodhime, ku zyrtaret doganorë edhe pse përdorin metodën e rivlerësimit (ngritjes) se çmimeve, prapëseprapë çmimet reale krahasuar me çmimet furnizuese (të blerjes) kanë dallime shumë të mëdha.

Është një dukuri e përditshme në Kosovë që kur kërkohet një faturë tatimore ajo pothuajse asnjëherë nuk korrespondon me shumën që është paguar. Fatura tatimore shpesh është disa herë më e ulët se sa pagesa reale. Kjo është praktikë e shumicës së bizneseve, prandaj TVSH-ja e mbledhshme është



disa herë më e ulët se TVSH-ja e paguar. Në kontekst të kësaj, inspektorët tatimorë me rastin e kontrollit e gëzojnë të drejtën e nivelizimit të çmimeve me ato të tregut, edhe pse shfrytëzimi i kësaj drejte ka përdorim të kufizuar ngase kontrollet nuk kryhen brenda vitit të njëjtë kalendarik, por ato zakonisht kryhen disa vite pas periudhës së raportimit.

Këto dukuri paraqiten në çdo biznes, por me shumë janë të theksuara në biznese që merren me ndërtimtari, material ndërtimor, teknikë të bardhë, mobilieri, automjete, autopjesë, tekstil, prodhime elektronike, argjendari etj. Bizneset të cilat merren me veprimtari shërbyese pothuajse janë të privileguara nga ky fenomen. Në këtë grup bëjnë pjesë: këngëtarët, studiot muzikore, avokatët, përkthyesit, restorantet, autoserviset, pishinat etj. Nga kjo mund të kuptojmë se sa e domosdoshme, dhe madje për momentin, e vetmja rrugë është vjelja e TVSH-së në kufi, sepse ende vetëdija e bizneseve kosovare është e ulët për vetëdeklarim real. Kjo formë sadopak arkëton një përqindje të TVSH-së më të lartë krahasuar me inkasimet e mbetura në 'ndërgjegjen' e bizneseve. Sa

i përket furnizimeve me pajisje për bizneset e reja është një lehtësim, sepse furnizimet (blerjet) e tilla janë të liruara për një periudhë gjashtëmujore nga TVSH-ja. Kjo do të thotë se biznesi me një kërkesë në ATK, me një plan biznesi dhe garancion bankar mund të lirohet nga pagesa momentale e TVSH-së. Megjithatë shtrohet pyetja se a është kjo kohë e mjaftueshme për investime serioze? Dhe përgjigjja është: sigurisht se jo. Asnjë investim serioz nga bizneset nuk mundet që brenda një periudhe gjashtëmujore të përfundojë me montimin e pajisjeve, testimin e tyre, fazën provuese të prodhimit, të përvetësojë tregun dhe të japë rezultate serioze me qëllim të kthimit-pagesës së TVSH-së. Prandaj kjo nënkupton ngulfatje të proceseve investuese. Shikuar nga ky këndvështrim, TVSH-ja nuk është aspak stimules, prandaj si rezultat i kësaj është që mungojnë investime të dimensioneve serioze në Kosovë. Deri me tani me legjislacionin që rregullon TVSH-në mjaft të dëmtuara kanë qenë bizneset shkollorë, të cilat janë trajtuar si çdo biznes tjetër, madje prodhimet bujqësore e në veçanti gruri, buka, tlyni, vaji ku janë trajtuar si çdo mall tjetër. Ky

gabim është përmirësuar me Ligjin nr.03/L-146 ku kjo kategori e bizneseve tani lirohet nga TVSH-ja (deri në nivelin e çmimeve të krahasueshme), prandaj besohet që çmimet e shërbimeve do të jenë më të lira me kualitete të avancuara. Ndërsa sa i përket prodhimeve bujqësore nuk ka logjikë që ushqimi i kafshëve të jetë i liruar nga TVSH-ë, kurse gruri, për prodhimin e miellit, mielli, buka, vaji, tlyni etj si produkte bazë për ushqim të mos jenë të liruara. Për këto produkte dhe produktet tjera ushqimore do të zbatohet norma e ultë e TVSH-së (nëse ministri i ekonomisë dhe financave nxjerr një akt nënligjor për këtë çështje). Element tjetër shqetësues është dominimi i ekonomisë informale i shoqëruar me fatura fiktive dhe fatura të lëshuara nga enklavat serbe në të cilat inspektorët tatimorë fare nuk kanë qasje.

ATK-ja është duke bërë përpjekje që të ndalë këto burime të keqpërdorimeve duke i pajisur bizneset me numra fiskalë dhe duke nxjerrë nga loja bizneset joaktive. Aplikimi i arkave fiskale që do të ketë si rezultat regjistrimin me kohë të transaksioneve kontabël dhe harmonizimin e çmimit kontabël me atë

të shitjes, do të duhej të zbusë sadopak keqpërdorimet fiskale dhe në mënyrë indirekte të kthejë besimin tek bizneset për një deklaram vullnetar dhe më real.

Me qëllim të trajtimit të drejtë të TVSH-së dhe tatimeve tjera direkte apo indirekte, është e nevojshme një udhëheqje e kontabilitetit të mirëfilltë nëpër biznese. Kjo nënkupton zbatimin e kontabilitetit financiar me regjistrime të dyfishta si dhe zbatimin e kontabilitetit material duke zbatuar regjistrimin e stoqeve me rastin e kontrolleve. Përputhshmëria e këtyre kontabiliteteve – zërave bilancor në aspektin kontabël siguron një qasje të drejtë ndaj pasurisë dhe burimeve të pasurisë. Jam i vetëdijshëm se me këtë artikull nuk janë adresuar të gjitha çështjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me tatimin mbi vlerën e shtuar. Prandaj, për fund po citoj një thënie të Bill Klintonit: "Unë nuk pretendoj t'u përgjigjem të gjitha çështjeve, por jam shumë i sigurt se ky është një problem që Amerikës nuk mund t'i kalojë (pa u zgjidhur)".

*Autori është ligjërues dhe menaxher në Zyrën e financave të UBT*





Në bazë të Statutit dhe Vendimit të Këshillit Drejtues nr.382/45-63, UBT shpall:

## KONKURS Programet

**Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi (BA, MA)**

**Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri (BSc, MSc)**

**Menaxhim i Mekatronikës (BSc, MSc)**

**Sistemet e Informacionit (BSc)**

**Juridik (LLB)**

**Përmes UBT ju mund të studioni edhe në:**  
Integrim dhe të drejtën Evropiane (Master, Cife France)  
Menaxhimin e Biznesit (MBA) nga Danube University in Krems (Austri)  
Information Systems (Master, WIT Ireland)

### Dokumentet e nevojshme:

Certifikata e lindjes, dëftesa e notave, diploma, dhe kopja e letërnjoftimit.

### Gjuha e studimeve:

Studenti ka mundësi të studiojë në gjuhën Shqipe apo në gjuhën Angleze.

### Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjërata të rregullta gjatë ditës, për të punësuarit ofrohen ligjërata pas orarit të punës, respektivisht gjatë fundjavës.

### Financat dhe pagesat:

**UBT ofron lirim për:**  
- Studentë të shkëlqyeshëm  
- Punjonjësit e Doganave  
- FSK, Policisë së Kosovës  
- Studentë që vijnë nga njëjta familje

Pagesa mund të bëhet edhe me këste mujore!

Përfshihen edhe materialet e nevojshme për studime.

**UBT angazhohet që t' u ofrojë studentëve të vetë bursa, praktikë dhe punësim.**

UBT është anëtare e shumë institucioneve ndërkombëtare dhe ka marrëveshje bashkëpunimi me mbi 40 universitete ndërkombëtare nga Evropa dhe Amerika

UBT është i vetmi Institucion i arsimit të lartë i certifikuar me ISO 9001



**Zgjidh më të mirin,  
që të bëhesh më i miri!**

Na kontaktoni në UBT,  
Lagja Kalabria p.n., Prishtinë,  
Tel:038541400,  
email:info@ubt-uni.net  
www.ubt-uni.net



# STUDIME NDËRKOMBËTARE KARRIERË • SUKSES • PRESTIGJ

**Që sukcesi juaj të jetë i garantuar (ashtu si gjeneratat e më parshme) UBT ju ofron:**

- Para studimeve dhe në fillim të studimeve - orientim profesional për secilin student
  - Kurse përgatitore falas për: gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë gjermane, matematikë, teknologji e informacionit, shkrim akademik, etj.
- **Gjatë studimeve - të njiheni me të arriturat e fundit të dijës në botë**
  - Metoda bashkëkohore të mësimdhënies sipas standardeve më të larta ndërkombëtare
  - Studime dhe specializime interdisciplinare shumë të kërkuara në tregun e punës
  - Dituritë dhe përvojat më të mira të profesorëve dhe ekspertëve eminentë nga universitete prestigjioze amerikane dhe evropiane, si dhe ekspertë vendas.
  - Ambient modern, komod dhe të pajisur me teknologji të avancuar
  - UBT është institucioni i vetëm në Kosovë, i cili ofron laboratorë të bashkëkohorë të teknologjisë dhe robotikës, të simulimit të biznesit, telekomunikacionit, etj.
  - UBT është institucioni i parë dhe i vetëm i arsimit të lartë në Kosovë i certifikuar me Standardin Ndërkombëtar për Menaxhim të Cilësisë: ISO 9001.
  - UBT ju ofron po ashtu:

- Infrastruktura dhe ambiente moderne për studime
- Bibliotekë dhe qasje elektronike në bibliotekat ndërkombëtare
- Salla leximi dhe literaturë të njëjtë me atë të universiteteve botërore
- Internet dhe intranet. Mundësi e videokonferencave me kolegë nga universitetet partnere
- Për të gjithë mundësi për praktika, vizita studimore, punësime sezonale në vend dhe jashtë vendit
- Forume, debate dhe konferenca shkencore me karakter ndërkombëtar
- Pjesëmarrje në gara prestigjioze me karakter ndërkombëtar (ROBOTIKË, BIZNES PLAN, PROJEKTE)
- Pjesëmarrje me pagesë në projektet profesionale dhe hulumtuese të UBT-së
- Aktivitete kulturore, sportive dhe arti
- Publikime në gazetën e UBT-së dhe në revistat e tjera profesionale shkencore
- Trajnime dhe Certifikime për Microsoft, CISCO, IPMA, QA, EOQ, etj.

### • Në fund të studimeve dhe pas diplomimit - PUNËSIM DHE KARRIERË TË GARANTUAR

- Përmes UBT Alumni Association, partnerëve nga biznesi dhe institucioneve në vend dhe jashtë vendit UBT, ofron përgatitje për tregun e punës, përkrahje për punësim dhe ngritje në karrierë.

- **Të gjithë të diplomuarit e UBT-së janë më të preferuarit në punësim.**

Përpos punësimit të shpejtë të tyre, ata kanë fituar edhe pozita të larta menaxhuese në Institucionet e Kosovës dhe jashtë vendit.

Ju nuk keni nevojë të shkoni jashtë vendit për studime cilësore.

**UBT ka sjellë në Kosovë trurin e universiteteve më të mira evropiane dhe amerikane.**